

Gjykata Themelore në Mitrovicë

P. Nr. 122/2014

23 tetor 2015

## Në emër të popullit

Gjykata Themelore në Mitrovicë/Mitrovica me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it, Dariusz Sielicki si Kryetar i trupit gjykues dhe Jorge Ribeiro dhe Katrien Witteman si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga Këshilltari Ligjor i EULEX-it Dukagjini Kerveshi në funksion si procesmbajtës në rastin penal P.No. 122/2014 kundër të akuzuarve si në vijim të akuzuar përmes aktakuzës PP.No. 363/2012 të parashtruar nga prokurori i Mitrovicës/Mitrovica Zyra e Prokurorisë Themelore me datë 13 nëntor 2014:

1. **S. S.** \_\_\_\_\_ (nofka '\_\_\_\_'), i lindur me \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_, vendlindja e panjohur; me kombësi \_\_\_\_\_; emri i babait  
\_\_\_\_\_; emri i nënës \_\_\_\_\_;
2. **B. J.** \_\_\_\_\_ (nofka '\_\_\_\_'), i lindur me \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_; \_\_\_\_\_ i Kosovës; emri i babait \_\_\_\_\_;  
emri i nënës \_\_\_\_\_;
3. **D. R.** \_\_\_\_\_ (nofka '\_\_\_\_'), i lindur me \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_; \_\_\_\_\_ i  
Kosovës; emri i babait \_\_\_\_\_; emri i nënës \_\_\_\_\_;
4. **Ž. J.** \_\_\_\_\_ i lindur me \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_;  
Kosovës; emri i babait \_\_\_\_\_; emri i nënës  
\_\_\_\_\_;

5. **B. Đ.** \_\_\_\_\_ (nofka ' \_\_\_\_\_ '), i lindur me \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_; \_\_\_\_\_ i Kosovës; emri i babait \_\_\_\_\_; emri i nënës \_\_\_\_\_;

6. **U. B.**, \_\_\_\_\_ i lindur me \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_; \_\_\_\_\_ i Kosovës; emri i babait \_\_\_\_\_; emri i nënës \_\_\_\_\_;

7. **R. T.** \_\_\_\_\_ (nofka ' \_\_\_\_\_ '), i lindur me \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_; \_\_\_\_\_ i Kosovës; emri i babait \_\_\_\_\_; emri i nënës \_\_\_\_\_;

pas shqyrtimit kryesore të gjykimit të mbajtur në publik dhe në prani të të gjithë të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, përkatësisht:

Dobrica Lazic për **S. S.** \_\_\_\_\_,

Faruk Korenica për **B. J.** \_\_\_\_\_,

Miodrag Brkljac për **D. R.** \_\_\_\_\_,

Agim Lushta për **Z. J.** \_\_\_\_\_,

Kapllan Baruti për **B. Dj.** \_\_\_\_\_,

Xhelal Hasani për **U. B.** \_\_\_\_\_,

Bogdan Vladislavljevic për **R. T.** \_\_\_\_\_;

me datat: 1, 27 dhe 29 korrik, 18 gusht, 4 dhe 8 shtator, 12, 21 dhe 23 tetor 2015; pas diskutimit dhe votimit të trupit gjykues mbajtur me 23 tetor 2015, në bazë të Nenit 359 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), në prani të të akuzuarit, avokatit të tij mbrojtës dhe prokurorit të EULEX-it të Zyrës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë/Mitrovica, me datë 23 tetor 2015 shpall publikisht si në vijim:

## A K T G J Y K I M

I. S. \_\_\_\_\_ S. \_\_\_\_\_ me anë të kësaj shpallet fajtor sepse: me \_\_\_\_\_, përafërsisht në ora \_\_:\_\_, ne qendër të \_\_\_\_\_, duke vepruar së bashku me një person tjetër të identifikuar dhe me 13 deri në 18 bashkë-kryes tjerë të paidentifikuar, ka sulmuar lirinë e personelit \_\_\_\_\_ të: \_\_\_\_\_ (në tekstin e mëtejshëm: \_\_\_\_\_) M. \_\_\_\_\_ B. \_\_\_\_\_, C. \_\_\_\_\_ C. \_\_\_\_\_, dhe M. \_\_\_\_\_ S. \_\_\_\_\_ që udhëtonin në bordin e një automjeti \_\_\_\_\_, me numër regjistrimi \_\_\_\_\_, e llojit(\_\_\_\_), duke e bllokuar rrugën para automjetit dhe duke gjuajtur gurë, duke spërkatur ngjyrë dhe duke e qëlluar pjesën e jashtme të makinës dhe dritaret me një çekan, duke thyer dy pasqyra për pamje të pasme të jashtme, dritaren e pasme dhe dritën e pasme, dhe duke e ngulfatur motorin duke vënë shkumë poliuretani në periskop të mjetit, dhe duke vepruar në këtë mënyrë S. \_\_\_\_\_ S. \_\_\_\_\_ ka penguar \_\_\_\_\_ në kryerjen e \_\_\_\_\_ të tyre \_\_\_\_\_ dhe po ashtu i ka shkaktuar dëme pronës së \_\_\_\_\_ që arrin shumën prej 8,500.20 Euro;

dhe duke vepruar në këtë mënyrë S. \_\_\_\_\_ S. \_\_\_\_\_ i ka kryer veprat penale si në vijim në bashkë-veprim:

I.1 Rrezikimi i Personelit të Kombeve të Bashkuara apo Personelit në Marrëdhënie me të në bashkë-kryerje sipas Nenit 142 paragrafi 2 dhe Neni 23 i Kodit Penal të Kosovës i datës 6 nëntor 2008 (KPK), dhe për këtë vepër penale, në bazë të Nenit 142 paragrafi 3 dhe Neni 23 i KPK-së, përmes kësaj ai dënohet me 1 (një) vit dhe (6) muaj burgim;

I.2 Pengimi i Personit Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare në bashkë-kryerje sipas Nenit 316 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së, dhe për këtë vepër penale, sipas nenit

316 Paragrafi 3 i KPK-së, përmes kësaj, ai dënohet me 6 (gjashtë) muaj burgim;

I.3 Sulmi Ndaj Personit Zyrtar Gjatë Kryerjes së Detyrave Zyrtare në bashkë-kryerje sipas Nenit 317 paragrafi 1 dhe Neni 23 i KPK-së, dhe për këtë vepër penale, sipas Nenit 317 Paragrafi 1 dhe Neni 23 i KPK-së, përmes kësaj ai dënohet me 8 (tetë) muaj burgim;

I.4 Dëmtimi i Pasurisë së Luajtshme në bashkë kryerje sipas Nenit 260 Paragrafi 1 dhe Neni 23 i KPK-së, dhe për këtë vepër penale, sipas Nenit 260 Paragrafi 1 dhe Neni 23 i KPK-së, ai përmes kësaj, dënohet me një gjobë në lartësi të shumës 1500 (një mijë e pesëqind) Euro.

II. B. \_\_\_\_\_ J. \_\_\_\_\_ përmes kësaj shpallet fajtor në lidhje me veprimin si në vijim: se me datë \_\_\_\_ \_\_\_\_ rreth orës \_\_\_\_:\_\_\_\_ min, afër fshatit \_\_\_\_\_, e ka sulmuar automjetin e \_\_\_\_\_ të markës \_\_\_\_\_ (e llojit të \_\_\_\_\_), numri i regjistrimit \_\_\_\_\_, e cila vozitej nga \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ i cili po e kryente \_\_\_\_\_ e tij \_\_\_\_\_, duke e thyer pasqyrën e jashtme në anën e djathtë gjersa po kalonte përmes një postblloku të improvizuar, dhe po ashtu ka shkaktuar dëm në pronën e \_\_\_\_\_ që arrin shumën në lartësi prej 599.14 Euro,

dhe duke vepruar në këtë mënyrë B. \_\_\_\_\_ J. \_\_\_\_\_ i ka kryer veprat penale si në vijim, në bashkë-veprim:

II.1 Rrezikimi i Personelit të Kombeve të Bashkuara apo Personelit në Marrëdhënie me të, sipas Nenit 142 Paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës i datës 6 nëntor 2008 (KPK) dhe për këtë vepër penale, sipas Nenit 142 Paragrafi 2 i KPK-së, përmes kësaj ai dënohet me 1 (një) vit dhe 4 (katër) muaj burgim;

II.2. Pengimi i Personit Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare sipas Nenit 316 Paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së, dhe për këtë vepër penale, në bazë të Nenit 316 Paragrafi 3 i KPK-së, përmes kësaj, ai dënohet me 4 (katër) muaj burgim;

II.3. Sulm Ndaj Personave Zyrtarë Gjatë Kryerjes së Detyrave Zyrtare, sipas Nenit 317 Paragrafit 1 të KPK-së. Dhe për këtë vepër penale, sipas Nenit 317 Paragrafit 1 të KPK-së, ai dënohet me 6 (gjashtë) muaj burgim;

II.4. Dëmtim të Pasurisë së Luajtshme, sipas Nenit 260 Paragrafit 1 të KPK-së. Dhe për këtë vepër penale, sipas Nenit 260 Paragrafit 1 të KPK-së, ai dënohet me gjobë në shumën prej 700 (shtatë qind) euro.

III. S. \_\_\_\_\_ S. \_\_\_\_\_ dhe B. \_\_\_\_\_ J. \_\_\_\_\_ përmes këtij aktgjykimi janë shpallur fajtor për veprimet vijuese: që më \_\_\_\_\_, ndërmjet diku rreth orës \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, afër \_\_\_\_\_, të akuzuarit, duke vepruar në bashkëkryerje me për afërsisht 18 deri 28 kryerës tjerë të panjohur dhe një person të identifikuar, e bllokuan rrugën përpara konvojit që përbëhej prej një automjeti të \_\_\_\_\_ dhe tri automjeteve të \_\_\_\_\_, vetura të tipit \_\_\_\_\_ (të \_\_\_\_\_), me numra të regjistrimit: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, me \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_: J. \_\_\_\_\_ R. \_\_\_\_\_, A. \_\_\_\_\_ W. \_\_\_\_\_, D. \_\_\_\_\_ D. \_\_\_\_\_, S. \_\_\_\_\_ S. \_\_\_\_\_ 1. dhe T. \_\_\_\_\_ A. \_\_\_\_\_ në to, të cilët po kryenin \_\_\_\_\_ e tyre \_\_\_\_\_, duke i parkuar automjete tjera dhe duke u vendosur në rrugë përpara konvojit, dhe pas rreth 40 minutash ata i sulmuan automjetet e lartcekura të \_\_\_\_\_ duke hedhur gurë, përderisa S. \_\_\_\_\_ S. \_\_\_\_\_ e theu pasqyrën e majtë të automjetit të \_\_\_\_\_, dhe dritën rrotulluese të kaltërt të policisë të \_\_\_\_\_

automjetit të \_\_\_\_\_, dhe duke e bërë këtë ata i shkaktuan dëme pronës së \_\_\_\_\_ në lartësinë e shumës prej 1,419.93 eurosh.

Dhe duke e bërë këtë, **S.**\_\_\_\_\_ **S.**\_\_\_\_\_ dhe **B.**\_\_\_\_\_ **J.**\_\_\_\_\_ kryen veprat në vijim, në bashkëveprim:

III.1. Rrezikimin e Personelit të Kombeve të Bashkuara dhe të Personelit në Marrëdhënie me to, në bashkëkryerje, sipas Nenit 142 Paragrafit 3 dhe Nenit 23 të Kodit Penal të Kosovës të datës 6 Nëntor 2008 (KPK). Dhe për këtë vepër penale, sipas Nenit 142 Paragrafit 3 dhe Nenit 23 të KPK-së, ata dënohen:

- **S.**\_\_\_\_\_ **S.**\_\_\_\_\_ me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim;
- **B.**\_\_\_\_\_ **J.**\_\_\_\_\_ me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim;

III.2. Pengimin e Personave Zyrtarë në Kryerjen e Detyrave Zyrtare, në bashkëkryerje, sipas Nenit 316 Paragrafit 1 dhe 3 dhe Nenit 23 të KPK-së. Dhe për këtë vepër penale, sipas Nenit 316 Paragrafit 3 dhe Nenit 23 të KPK-së, ata dënohen:

- **S.**\_\_\_\_\_ **S.**\_\_\_\_\_ me 8 (tetë) muaj burgim;
- **B.**\_\_\_\_\_ **J.**\_\_\_\_\_ me 8 (tetë) muaj burgim;

III.3. Sulm Ndaj Personave Zyrtarë Gjatë Kryerjes së Detyrave Zyrtare, në bashkëkryerje, sipas Nenit 317 Paragrafit 1 dhe Nenit 23 të KPK-së. Dhe për këtë vepër penale, sipas Nenit 317 Paragrafit 1 dhe Nenit 23 të KPK-së, ata dënohen:

- **S.**\_\_\_\_\_ **S.**\_\_\_\_\_ me 10 (dhjetë) muaj burgim;

- **B.**\_\_\_\_\_ **J.**\_\_\_\_\_ me 10 (dhjetë) muaj burgim;

III.4. Dëmtim të Pasurisë së Luajtshme, në bashkëkryerje, sipas Nenit 260 Paragrafit 1 dhe Nenit 23 të KPK-së. Dhe për këtë vepër penale, sipas Nenit 260 Paragrafit 1 dhe Nenit 23 të KPK-së, ata dënohen:

- **S.**\_\_\_\_\_ **S**\_\_\_\_\_ me gjobën në lartësinë e shumës prej 1,000 (njëmijë) euro;

- **B.**\_\_\_\_\_ **J.**\_\_\_\_\_ me gjobën në lartësinë e shumës prej 1,000 (njëmijë) euro;

IV. Sipas Nenit 71 Paragrafit 1 Nën-paragrafit 2.1 dhe 2.2 të KPK-së, për veprat e lartcekura penale **S.**\_\_\_\_\_ **S.**\_\_\_\_\_ dënohen me dënimin unik prej 2 (dy) vjet burgim dhe gjobën në lartësinë e shumës prej 2,000 (dymijë) eurosh;

V. Sipas Nenit 71 Paragrafit 1 Nën-paragrafit 2.1 dhe 2.2 të KPK-së, për veprat e lartcekura penale **B.**\_\_\_\_\_ **J.**\_\_\_\_\_ dënohet me dënimin unik prej 1 (një) vjet e 10 (dhjetë) muaj burgim, dhe gjobën në lartësinë e shumës prej 1,500 (njëmijë e pesëqind) Eurosh;

VI. Sipas Nenit 43 Paragrafit 2 dhe Nenit 44 Paragrafit 1 të KPK-së, dënimi unik i shqiptuar ndaj **S.**\_\_\_\_\_ **S.**\_\_\_\_\_ nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk e kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës provuese prej 4 (katër) vitesh;

VII. Sipas Nenit 43 Paragrafit 2 dhe Nenit 44 Paragrafit 1 të KPK-së, dënimi unik i shqiptuar ndaj **B.**\_\_\_\_\_ **J.**\_\_\_\_\_ nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk e kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës provuese prej 4 (katër) vitesh;

VIII. Sipas Nenit 364 Paragrafit 1 Nën-paragrafit 1.3 të KPPRK-së, S. \_\_\_\_\_ S. \_\_\_\_\_ lirohet nga veprimet vijuese: që më \_\_\_\_\_, rreth orës \_\_:\_\_, në qendër të \_\_\_\_\_, duke vepruar së bashku me një person tjetër të identifikuar si dhe kryes të tjerë të panjohur kanë sulmuar veturën e \_\_\_\_\_ duke hedhur gurë dhe gjëra të ndryshme, duke e ngjyrosur veturën dhe dritaret e saj me sprejë për të bllokuar të parit e \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ që ndodheshin brenda, duke goditur veturën me çekiç për ti thyer dritaret për të hyrë Brenda në veturë dhe për ti dëmtuar udhëtarët, e cila gjë është klasifikuar në aktakuzë si:

Vepra penale e Pjesëmarrja në Grup që Kryen Vepër Penale në kundërshtim me nenin 320 paragrafi 1, në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës *pari materia* me nenin 412 paragrafi 1, në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës më 20 prill 2012 (KPRK),

pasi që nuk është vërtetuar se ai ka kryer këtë vepër penale;

IX. Sipas nenit 364 Paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 KPPRK-së, D. \_\_\_\_\_ R. \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ Ž. \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ B. Đ. \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ U. B \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ R.T. \_\_\_\_\_ me anë të kësaj janë të liruar nga veprimet si në vijim: se më \_\_\_\_\_ në mes të orëve \_\_:\_\_ dhe \_\_:\_\_, afër fshatit \_\_\_\_\_, të pandehurit kanë vepruar bashkërisht me kryesit e panjohur, në kryerjen e veprës penale të rrezikimit të Kombeve të Bashkuara apo personelin bashkëpunues, ku ata po mundoheshin që të hynin brenda në veturë duke hedhur gurë në vetura dhe duke u munduar që të shfrynin gomat



për ti bërë veturat të palëvizshme, veprim ky që është klasifikuar në aktakuzë si vepra penale të:

- IX.1 Rrezikimi i Personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i Personelit në Marrëdhënie me to në kundërshtim me nenin 142 paragrafët 3 dhe 6.2.1, në lidhje me nenin 23 të KPK-së *pari materia* me nenin 174 paragrafët 3 dhe 6.2.1, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;
- IX.2 Pengimi i Personit Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 316, paragrafi 1, në lidhje me nenin 23 të KPK-së *pari materia* me nenin 409 paragrafi 1, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;
- IX.3 Sulm Ndaj Personit Zyrtar Gjatë Kryerjes së Detyrave Zyrtare në bashkë kryerje në kundërshtim me nenin 317 paragrafi 1, në lidhje me nenin 23 të KPRK-së *pari materia* me nenin 410 paragrafi 1, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;
- IX.4 Pjesëmarrja në Grup që Kryen Vepër Penale në bashkë kryerje, në kundërshtim me nenin 320 paragrafi 1, në lidhje me nenin 23 të KPK-së *pari materia* me nenin 412 paragrafi 1, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së;
- IX.5 Dëmtimi i Pasurisë së Luajtshme në bashkë kryerje në kundërshtim me nenin 260 paragrafët 1 dhe 2, në lidhje me nenin 23 të KPK-së *pari materia* me nenin 333 paragrafët 1 dhe 4, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së,
- sepse nuk është vërtetuar se ata kanë kryer vepra penale;
- X. Sipas nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPPRK-së S.\_\_\_\_\_ S.\_\_\_\_\_ dhe B.\_\_\_\_\_ J.\_\_\_\_\_ me anë të kësaj janë të liruar nga veprimet si në vijim: se më \_\_\_\_\_

\_\_\_\_ në mes të orëve \_\_:\_\_ dhe \_\_:\_\_, në rajonin afër fshatit \_\_\_\_\_, të akuzuarit duke vepruar së bashku me: D.\_\_\_\_ R.\_\_\_\_, Ž.\_\_\_\_ J.\_\_\_\_, B.\_\_\_\_ Đ.\_\_\_\_, U.\_\_\_\_ B.\_\_\_\_ dhe R.\_\_\_\_T.\_\_\_\_, një person tjetër i identifikuar dhe bashkëkryerës te tjerë te panjohur, në kryerjen e veprave penale të Rrezikimit të Kombeve të Bashkuara apo Personelin Bashkëpunues, ku ata po mundoheshin që të hynin brenda në vetura të \_\_\_\_\_ duke hedhur gurë në vetura dhe duke u munduar që të shfrynin gomat për ti bërë veturat të palëvizshme, veprim ky që është klasifikuar në aktakuzë si vepra penale të Pjesëmarrja në Grup që Kryen Vepër Penale në kundërshtim me nenin 320 paragrafi 1, në lidhje me nenin 23 të KPK-së *pari materia* me nenin 412 paragrafi 1, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së sepse nuk është vërtetuar se ata kanë këtë vepër penale;

XI. Sipas nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i KPPRK-së akuzën kundër S.\_\_\_\_ S.\_\_\_\_ që përbënë veprat si në vijim: se më \_\_\_\_\_ ndërmjet orëve \_\_:\_\_ dhe \_\_:\_\_, në rajonin afër fshatit \_\_\_\_\_, ai ka vjedhur dritën e kaltër të \_\_\_\_\_ nga pjesa e sipërme e veturës së \_\_\_\_\_, veprim ky i cili është klasifikuar në aktakuzë si vepër penale të Vjedhjes nën nenin 252 paragrafi 1 të KPK-së, me anë të kësaj është refuzuar sepse prokurori ka tërhequr akuzat;

XII. Sipas nenit 83 paragrafi 1 i KPK-së, periudha e privimit të lirisë së S.\_\_\_\_ S.\_\_\_\_ nga 15 maj 2014 deri më 15 korrik 2015 përderisa gjendej ne burgim, është përfshirë në burgim të caktuar për të në rast të zbatimit të tij;

XIII. Sipas nenit 453 paragrafi 3 i KPPRK-së, çmimi i shpenzimeve të procedimeve penale do të duhet që

pjesërisht të rimbursohen nga S. \_\_\_\_\_ S \_\_\_\_\_ dhe B. \_\_\_\_\_ J. \_\_\_\_\_ në shumën e caktuar prej 150 eurosh për secilin, ndërsa çdo shpenzim i mbetur do të duhet të paguhet nga burimet e buxhetit.

## R E A S O N I N G

### I. Historiku procedural

#### a. Aktakuza

1. Me datën 19 tetor 2012, Zyra e Prokurorisë Publike te Qarkut parashtroi Aktvendim mbi Fillimin e Hetimit te datës 18 tetor 2012 ne rastin PP.No. 363/2012, duke filluar hetimin penale kundër te pandehurve S. S. dhe S. V. për veprat penale te Rrezikimi i Personelit të Kombeve të Bashkuara apo Personelit në Marrëdhënie me të, Pengimi i Personit Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare, Pjesëmarrja në Grup që Kryen Vepër Penale dhe Dëmtim te pasurisë se luajtshme ne lidhje me incidentin i cili ka ndodhur me \_\_\_\_ \_\_\_\_ duke përfshirë sulmet kundër tre \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ së \_\_\_\_\_.
2. Më 27 nëntor 2013, Zyra e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës parashtroi një aktvendim mbi zgjerimin e hetimit te datës 26 nëntor 2013, në të cilin prokuroria vazhdoi dhe rikualifikoi veprat penale sa i përket pikës A: Rrezikimi i Personelit të Kombeve të Bashkuara apo Personelit në Marrëdhënie me të, Pengimi i Personit Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare, Pjesëmarrja në Grup që Kryen Vepër Penale dhe Dëmtim te pasurisë se luajtshme ne lidhje me incidentin i cili ka ndodhur me \_\_\_\_ \_\_\_\_

\_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ kundër të pandehurve **S. S.** dhe **S. V.**; dhe sa i përket pikës B: Rrezikimi i Personelit të Kombeve të Bashkuara apo Personelit në Marrëdhënie me të, Pengimi i Personit Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare, Pjesëmarrja në Grup që Kryen Vepër Penale dhe Dëmtim te pasurisë se luajtshme, ne lidhje me incidentin i cili ka ndodhur me datën \_\_\_\_\_ ne \_\_\_\_\_ kundër te pandehurve **S. S.** dhe **B. J.**

3. Me datën 13 mars 2014, Kryetari i Asamblesë se Gjyqtarëve të EULEX-it lëshoi një Vendim me Nr. 2014.OPEJ.0147-0001 te datës 13 mars 2014 ne te cilin lënda penale PP.No. 363/012 (PPS.No. 113/2012) iu ishte caktuar ne kompetence dhe përgjegjësi te Gjyqtarëve te EULEX-it.
4. Më 23 prill 2014, prokuroria parashtroi aktvendim mbi zgjerimin e hetimit te datës 22 prill 2014, me anë të kësaj duke zgjeruar hetimin për të përfshirë të pandehurit **S. V., B. J., D. R., Z. J., B. D.** dhe **U. B.** si të dëshuar të rinj në lidhje me pikën B.
5. Më 16 korrik 2014, prokuroria parashtroi Aktvendim mbi zgjerimin e hetimit te datës 15 korrik 2014, me anë të kësaj duke e zgjeruar hetimin për të përfshirë **S. R.** në lidhje me pikën A dhe të pandehurit **S. R.** dhe **R. T.** në lidhje me pikën B.
6. Më 10 tetor 2014 Prokurori i EULEX-it i Zyrës së Prokurorisë së Mitrovicës ngriti aktakuzën PP. No. 363/2012 (PPS 113/2012) të datës 10 tetor 2014 kundër **S. S., S. V., B. J., D. R., Z. J., B. D., U. B.** dhe **R. D.** Aktakuza në mënyrë origjinale ishte paraqitur në

mënyrë narrative, dhe në formë të pastrukturuar. Edhe pse ajo përmbante të gjitha elementet e nevojshme të paraqitura në Nenin 241 të KPPRK, gjatë seancës fillestare të mbajtur më 7 nëntor 2014 kryetari i trupit gjykues udhëzoi prokurorin të paraqes akuzat në mënyrë të rregullt.

7. Prokurori prezantoi aktakuzën e korrigjuar të datës 12 nëntor 2014 me shkrim në një format të strukturuar më 14 nëntor 2014. Aktakuza e korrigjuar nuk paraqiti asgjë plotësuese në përmbajtje, por pikat kundër çdo të pandehur të veçantë ishin përshkruar në mënyrë transparente dhe u prezantuan së bashku me klasifikimin e tyre relevant ligjor.
8. Sipas aktakuzës së korrigjuar, **S. S.**, dhe **S. V.**, ishin akuzuar për veprat në vijim: që më \_\_\_\_\_, rreth orës \_\_:\_\_, në qendër të qytetit të \_\_\_\_\_, duke vepruar së bashku me një person tjetër të identifikuar si dhe kryes të tjerë të panjohur kanë sulmuar veturën e \_\_\_\_\_ duke hedhur gurë dhe gjëra të ndryshme, duke e ngjyrosur veturën dhe dritaret e saj me sprejë për të bllokuar të parit e \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ që ndodheshin brenda, duke goditur veturën me çekiç për ti thyer dritaret për të hyrë Brenda në veturë dhe për ti dëmtuar udhëtarët e saj:

dhe e cila gjë është klasifikuar në aktakuzë si:

- I. Vepra penale e Rrezikimit te Personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i Personelit në Marrëdhënie me to në kundërshtim me nenin 142 paragrafët 3 dhe 6.2.1, në lidhje me nenin 23 të KPK-së *pari materia* me nenin 174 paragrafët 3 dhe 6.2.1, në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal te Republikës se Kosovës (2013) (Pika A1);

- II. Vepra penale e Pengimit te Personit Zyrtar në Kryerjen e Detyrave Zyrtare në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 316, paragrafi 1, në lidhje me nenin 23 të KPK-së *pari materia* me nenin 409 paragrafi 1, në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal te Republikës se Kosovës (2013) (Pika A2);
- III. Vepra penale e Sulm Ndaj Personit Zyrtar Gjatë Kryerjes së Detyrave Zyrtare në bashkë kryerje në kundërshtim me nenin 317 paragrafi 1, në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal te Kosovës *pari materia* me nenin 410 paragrafi 1, në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal te Republikës se Kosovës (2013) (Pika A3);
- IV. Veprën penale te Pjesëmarrjes ne Grup qe Kryen Vepër Penale ne kundërshtim me nenin 320, paragrafi 1, ne lidhje me nenin 23 te Kodit Penal te Kosovës *pari materia* me nenin 412, paragrafi 1, ne lidhje me nenin 31 te Kodit Penal 2013 (Pika A4);
- V. Veprën penale te dëmtimit te Pasurisë se Luajtshme ne kundërshtim me nenin 260, paragrafët 1 dhe 2, ne lidhje me nenin 23 te Kodit Penal te Kosovës *pari materia* me nenin 333, paragrafët 1 dhe 4, ne lidhje me nenin 31 te Kodit Penal 2013 (Pika A5).
9. Aktakuza përbëhet prej pjesëve thelbësore te informatave, te cilat se bashku plotësojnë elementet e veprave penale te nevojshme për kualifikim ligjor, sikurse qe është cituar me lart:
- Automjeti i përmendur ne përshkrim te akuzave ishte TOYOTA Land Cruiser, me numër te regjistrimit \_\_-\_\_\_\_-\_\_\_\_, i llojit \_\_ ( \_ \_\_\_\_\_ );
  - \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_ se \_\_\_\_\_ M. B.,



C. C. dhe M. C. S. ishin ne automjet ne kohen relevante;

- \_\_\_\_\_ po udhëtonin për qëllime te ndërlidhura me detyre;
- S. S. e theu pasqyrën e djathte te automjetit dhe S. V. beri me sprej automjetin;
- Si rezultat i veprimeve te kryera nga te akuzuarit automjeti ishte dëmtuar ne shumen prej 8,808.85 eurove.

10. Me tej, sipas aktakuzës se korrigjuar S. S., S. V., B. J., D. R., Z. J., B. D., U. B. dhe R. D. ishin akuzuar për veprat ne vijim:

Qe me \_\_\_\_\_, ndërmjet diku rreth orës \_\_:\_\_ dhe \_\_:\_\_, ne afërsi te fshatit \_\_\_\_\_, te pandehurit duke vepruar ne bashkëkryerje me bashkë kryerës te tjerë te panjohur, ne kryerje te veprës penale te Rrezikimit te Personelit te Kombeve te Bashkuara apo Personit ne Marrëdhënie me te, kur ata po mundoheshin qe te hynin brenda ne automjete te \_\_\_\_\_, duke hedhur gurë ne automjete dhe duke u munduar qe te shfrynin gomat për ti bere automjetet te palëvizshme,

Dhe ky veprim është klasifikuar ne aktakuze si:

VI. Veprën penale te Rrezikimit te Personelit te Kombeve te Bashkuara dhe i Personelit ne Marrëdhënie me to ne kundërshtim me nenin 142, paragrafët 3 dhe 6.2.i, ne lidhje me nenin 23 te Kodit Penal te Kosovës *pari materia* me nenin 174, paragrafët 3 dhe 6.2.1, ne lidhje me nenin 31 te Kodit Penal 2013. Ne lidhje me këtë pikë, vepra penale gjithashtu përfshin pretendimin që te akuzuari e ka vjedhur dritën e kaltër të \_\_\_\_\_ nga



njëri nga automjetet (Pika B1);

VII. Veprën penale të Sulmit Ndaj Personit Zyrtar Gjatë Kryerjes së Detyrave Zyrtare në kundërshtim me nenin 316 paragrafi 1, në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës *pari materia* me nenin 409 paragrafi 1, në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal 2013 (Pika B2);

VIII. Veprën penale të Sulmit ndaj Personit Zyrtar Gjate Kryerjes se Detyrave Zyrtare ne kundërshtim me nenin 23 te Kodit Penal te Kosovës *pari materia* me Nenin 410, paragrafi 1, ne lidhje me Nenin 31 te Kodit Penal 2013 (Pika B3);

IX. Veprën penale të Pjesëmarrjes në Grup që Kryen Vepër Penale në kundërshtim me Nenin 320, paragrafi 1, në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës *pari materia* me nenin 412, paragrafi 1, në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal 2013 (Pika B4);

X. Veprën penale të Dëmtimit të Pasurisë së Luajtshme në kundërshtim me Nenin 260, paragrafët 1 dhe 2, në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës *pari materia* me nenin 333, paragrafët 1 dhe 4, në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal 2013 (Pika B4);

11. Pjesët e tjera thelbësore të informatave, të cilat së bashku plotësojnë elementet e veprave penale të nevojshme për kualifikim ligjor, sikurse që është cituar më lart, janë:

- Automjetet e përshkruara më lart në akuzë ishin 3 Toyota Landcruiser, automjete të llojit \_\_ ( \_\_ \_\_\_\_\_ ), me numra të regjistrimit: \_\_-\_\_\_\_-\_\_, \_\_-\_\_\_\_-\_\_ dhe

- \_\_-\_\_\_\_-\_\_\_\_;
- Kishte pasur \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ së \_\_\_\_\_ J. R., A. W., D. D., S. S. 1. dhe T. A. në automjete;
  - \_\_\_\_\_ po kryenin detyrat e tyre zyrtare.
  - **B. J.** e theu pasqyrën e majtë të automjetit \_\_-\_\_\_\_-\_\_\_\_ përderisa automjeti ishte duke kaluar një postblock afër \_\_\_\_\_.

12. Vlera e dëmit të shkaktuar nuk është përmendur në aktakuzë.

13. **S. S.** gjithashtu ishte akuzuar për veprimet në vijim:

Që më \_\_ \_\_\_\_ ndërmjet orëve \_\_:\_\_ dhe \_\_:\_\_, afër fshatit \_\_\_\_\_, kishte vjedhur një dritë me ngjyrë të kaltër të \_\_\_\_\_ nga kulmi i automjetit të \_\_\_\_\_ \_\_-\_\_\_\_-\_\_\_\_,

Dhe ky veprim është klasifikuar në aktakuzë si:

XI. Vepër penale e vjedhjes në kundërshtim me nenin 252, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës *pari materia* me nenin 325, paragrafi 1 i Kodit Penal 2013.

14. Vlera e "dritës së kaltër \_\_\_\_\_" nuk ishte cituar në aktakuzë.

15. Sipas nenit 245 të KPPRK, një seancë fillestare ishte mbajtur më 7 nëntor 2015 dhe pastaj më 17 nëntor 2015.

16. Rasti kundër të pandehurit **S. V.** më vonë ishte shërbyer në aktvendimin gojor të trupit gjykues të datës 1

korrik 2015 në fillim të shqyrtimit kryesor. Kjo ishte për shkak të i pandehuri dështoi që paraqitet në gjykatë<sup>1</sup>.

**b. Kundërshtimet në aktakuzë dhe Pranueshmëria e provave**

7. Me vendimin mbi kundërshtimet e provave të mbrojtjes dhe kërkesën për të hedhur poshtë aktakuzën së kryetarit të trupit gjykues të datës 15 janar 2015, kundërshtimet në pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë të parashtruar nga të gjithë avokatët mbrojtës, së bashku me kërkesat për të hedhur poshtë aktakuzën, ishin refuzuar si të pabazuara përveç kërkesën e avokatit mbrojtës Miodrag Brkljac për të pandehurin **D. R.** të datës 9 dhjetor 2014 për të hedhur poshtë aktakuzën e cila ishte aprovuar nga kryetari i trupit gjykues. Kryetari i trupit gjykues hodhi poshtë aktakuzën kundër të pandehurit **D. R.** dhe suspendoi procedurën penale kundër \_\_\_\_.
8. Vendimi në Kundërshtimin e mbrojtjes në prova dhe kërkesën për të hedhur poshtë aktakuzën ishte ankimuar nga të gjithë të pandehurit përmes avokatit mbrojtës, përveç për të pandehurin **D. R.**, dhe prokuroria.
9. Nga Aktvendimi mbi ankesat (PN 79/15) të datës 2 dhe 3 prill 2015, Gjykata e Apelit vërtetoi pjesërisht Vendimin e kryetarit të trupit gjykues të datës 15 janar 2015. Gjykata e Apelit e ndryshoi dispozitivin e Vendimit të datës 15 janar 2015 për të refuzuar si të pabazuar kërkesën e avokatit mbrojtës Miodrag Brkljac të datës 9 dhjetor 2014 në emër të pandehurit **D. R.**.

---

<sup>1</sup> Procesverbal I Shqyrtimit Kryesor, 1 korrik 2015, f. 2, l. 35-55;

**c. Kompetenca e Gjykatës dhe përbërja e trupit gjykues**

1. Sipas Nenit 11, paragrafi 1 te Ligjit mbi Gjykatat, Ligji Nr. 03/L-199, juridiksioni për të gjykuar të gjitha veprat penale në shkallë të parë i përket gjykatës themelore.
2. Aktakuza tregoi që veprat penale që përbëjnë akuzat ishin kryer në \_\_\_\_\_ që është në territor të Gjykatës Themelore të Mitrovicës. Për këtë arsye, sipas nenit 29, paragrafi 1 i KPPRK, kjo gjykatë ka kompetencë territoriale për të gjykuar rastin.
3. Sipas nenit 286 të KPPRK, shqyrtimi kryesor duhet të mbahet në vendin ku gjykata e ka selinë e vet, dhe në gjykatore.
4. Është fakt i njohur që prej marsit 2008 deri në ditën kur është nxjerrë aktgjykimi, për shkak të kriterëve të sigurimit specifik në veri të Mitrovicës, praktika fuqimisht është vërtetuar që rastet penale në Gjykatën Themelore të Mitrovicës janë gjykuar nga kolegjet gjyquese të përbëra prej ekskluzivisht gjyqtarëve të EULEX-it. Kjo praktikë kurrë nuk është kontestuar nga gjykatat e ndonjë shkalle. Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore si dhe Neni 31, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parashohin të drejtën për qasje në gjykatë jo vetëm për të pandehurit, por gjithashtu për palët e dëmtuara. Nocioni i "gjykata e themeluar me ligj" i cili është përdorur në dispozitat e përmendura i referohet gjithashtu legjislacionit vendor mbi juridiksionin territorial dhe faktik. Është paraqitur që pjesëmarrja ekskluzive e gjyqtarëve të EULEX-it ishte mënyra më e mirë për të vëzhguar të drejtën në qasje të gjykatës.
5. Zëvendës kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës, sipas Ligjit Nr. 04/L-0273 duke ndryshuar dhe plotësuar ligjet në

lidhje me mandatin e Misionit të Sundimit të Ligjit të BE-së në Republikën e Kosovës dhe bazuar në Nenin 5, paragrafi (1) i Marrëveshjes ndërmjet Drejtuesit të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi aspektet relevante të operacionit dhe bashkëpunimit të EULEX-it dhe gjyqtarëve vendor të nënshkruar më 18 tetor 2014, më 13 tetor 2014 nxori Vendimin GJA.nr.579/14 duke i caktuar lëndën penale P.nr. 122/2014 gjyqtarëve të EULEX-it.

6. Më 23 mars 2015, Këshilli Gjyqësor i Kosovës i Republikës së Kosovës nxori një vendim për Aprovim të Kërkesës nga EULEX-i për të vazhduar shqyrtimin gjyqësor të lëndës Nr. P. 122/14 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë KGJK Nr. 23/2015, me anë të kësaj duke miratuar që rasti do të mbetet tek gjyqtarët e EULEX-it.
7. Asnjë çështje nuk ishte ngritur nga palët në lidhje me përbërjen e trupit gjykues. Prandaj, është konsideruar që sipas nenit 382, paragrafi 4 i KPPRK ata kanë hequr dorë nga e drejta për të kundërshtuar përbërjen.

#### **d. Shqyrtimi Kryesor**

##### **i. Kohëzgjatja e Shqyrtimit Kryesor**

1. Shqyrtimi kryesor filloi më 1 korrik 2015 dhe ishte lidhur më 23 tetor 2015. Ishte mbajtur ai me 9 ditë të seancave.
2. Kohëzgjatja e shqyrtimit kryesor nuk e ka tejkaluar afatin prej 120 ditëve kalendarike të parapara në nenin 314, paragrafi 1.2 të KPPRK. Gjithashtu, çdo shtyrje e urdhëruar

nga trupi gjykues nuk ka tejkaluar 30 ditshin dhe çdo herë është arsytuar r nga treguesi i veprimeve procedurale për t'u ndërmarrë gjatë seancës së ardhshme të gjykatës.

**ii. Masat e ndërmarra për të siguruar qasje publike në gjykatore**

19. Qasja e publikut ishte ndihmuar duke shpallur datat e seancave gjatë çdo seance të gjykatës dhe veç kësaj në ueb faqen e EUEX-it. Policia e Kosovës ka ndihmuar anëtarët e publikut për të arritur në gjykatore. Nuk ishin raportuar incidente të sigurisë në lidhje me lëvizjet e anëtarëve të publikut në Veri të Mitrovicës. Asnjë ankesë në lidhje me kufizimet apo pengesat e qasjes nuk janë paraqitur në gjykatore tek trupi gjykues.

**iii. Sigurimi në gjykatë**

1. Kishte pasur masa normale të sigurisë të aplikuar gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor. Këto pengesa të përfshira mbi sjelljen e gjësendeve të mëdha në gjykatore, kontrollimet personale me zbulues të metalit në hyrje të gjykatës. Zyrtarët policor të Kosovës ishin të pranishëm në gjykatore. Nuk kishte pasur incidente të sigurisë të raportuara në gjykatë.

**iv. Prania e palëve**

1. Prokurorët e EULEX-it të Zyrës së Prokurorisë së Mitrovicës në Kosovë, të akuzuarit dhe avokati i tyre mbrojtës ishin të pranishëm në të gjitha ditët e seancave.

#### **v. Gjuha e procedurës, interpretimi dhe procesmbajtja**

1. Bazuar në Nenin 16 të Ligjit mbi Juridiksionin dhe Kompetencat e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, gjuha e përdorur në procedurë të gjykatës ishte Anglishtja.
2. Në pajtim me nenin 1, paragrafi 2 i KPPRK, interpretët kanë përkthyer seancat gjyqësore dhe të gjitha dokumentet e gjykatës relevante për trupin gjykues nga Anglishtja në Serbisht dhe e kundërta. E shumta e përkthimit ishte kryer në mënyrë konsektive. Është kërkuar nga folësit prej kryetarit të trupit gjykues të pauzojnë në fjalimin e tyre, zakonisht çdo 1 deri në 3 minuta dhe si parim në fund një mendim të tërësishëm, dhe pastaj interpreti përktheu atë që ishte thënë. Kjo metodë lejonte interpretim të saktë të gjitha provave të marra në gjykatore. Veç kësaj, anëtarëve të publikut iu ishte ofruar përkthim konsektiv në Gjuhën shqipe. Nuk kishte pasur kundërshtime në lidhje me kualitetin e interpretimit.
3. Fjala përfundimtare e palëve dhe shpallja e dispozitivit të aktgjykimit ishin përkthyer në mënyrë simultane në Anglisht, Shqip dhe Serbisht.
4. Sipas vendimit të kryetarit të trupit gjykues të marrë sipas nenit 315, paragrafët 2 dhe 5 të KPPRK, procesverbali i seancës ishte bërë fjalë për fjalë me shkrim dhe pa audio, video apo incizim stenografik për shkak të kohës të shfrytëzuar për përkthim i lejonte procesmbajtësit që në

mënyrë të saktë të zë dhe shënoj të gjitha fjalët e folura në gjykatore.

5. Saktësia e shënimeve të shkruara ishte kontrolluar nga kryetari i trupit gjykues në kohën e duhur. Ekran i kompjuterit që i tregonte shënimet ishte vendosur para tij. kjo mënyrë e regjistrimit i bëri përdorimin e metodave të tjera të regjistrimit/incizimit të tepërta pasi që dukej se vështirë që ata do të mund të arrinin në një mënyrë më të saktë të regjistrimit. Nuk kishte pasur kundërshtime në saktësinë e proces mbajtjes.

#### **vi. Karakteri publik i seancës**

1. Seanca ishte mbajtur në gjykatë të hapur. Asnjë pjesë e seancës nuk është mbajtur në seancë të mbyllur.

#### **vii. Marrja në pyetje e dëshmitarëve**

##### **1. Parimet e aplikuara për marrje në pyetje**

##### **a. Pyetjet sugjestive, provokuese, ngacmuese dhe të tjerat të ngjashme**

1. Si parim, pyetjet sugjestive në marrjen direkte në pyetje nuk ishin të lejuara nga kryetari i trupit gjykues. Pritjet e vetme ishin lejuar kur rimarrja e fakteve nga dëshmitari ishte shfrytëzuar në mënyrë të qartë, kur kishte nevojë të fokusohet vëmendja e dëshmitarit në një çështje të veçantë,



apo kur pyetja kishte prekur në çështjen duke qenë në dijeni të zakonshme dhe të qartë.

2. Pyetje sugjestive dhe përsëritëse gjithashtu nuk ishin të lejuara në këtë fazë.
3. Ngacmimi i dëshmitarit dhe keq citimi i deklaratave të mëhershme nuk ishin lejuar gjatë tërë marrjes në pyetje.

#### **b. Marrja në pyetje nga gjyqtarët**

1. Trupi Gjykses ka marrë pjesë në mënyrë aktive në marrjen në pyetje të dëshmitarëve në faza të ndryshme të marrjes në pyetje. Sidoqoftë, palët gjithnjë iu është dhënë rasti të kundërshtojnë pyetjet e dhëna nga dëshmitari në pyetje të gjyqtarit. Trupi gjykses bazuar në aktivitetin e tij duke marrë në pyetje që neni 7, paragrafi 1 i KPPRK i obligon gjyqtarët të kërkojnë të vërtetën objektive. Prandaj, një qartësim tepër i përpiktë të gjitha çështjeve faktike që paraqiten tek gjyqtarët që është e paqartë ishte e nevojshme. Neni 299, paragrafi 1 i KPPRK i jep të drejtë gjyqtarëve të bëjnë pyetje çdo dëshmitari por nuk tregon ndonjë fazë të veçantë të marrjes në pyetje. Paraqitet që kodi nuk jep ndonjë kufizim në lidhje me kohën e marrjes në pyetje nga gjyqtarët.
2. Më 29 korrik 2015 prokurori gjatë marrjes në pyetje direkte të dëshmitarit C. C. pyeti nëse dëshmitari qëndronte pranë deklaratave të tij të mëparshme dhe nëse ai dëshironte të "miratonte" atë për seancë. Të gjitha pyetjet tjera të bëra nga prokurori kishin të bënin me opsionet e dëshmitarëve, përshtypjet dhe spekulimet por jo me ngjarjet kritike.

3. Kryetari i trupit gjykues u përgjigj ne mënyrën vijuese:

*[...] fatkeqësisht sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ne nuk mund të mbështetemi në deklaratën e mëparshme. Deklarata e dëshmitarëve të procedurës paraprake mund të prezantohet në gjykatë gjatë marrjes në pyetje në mënyrë direkte vetëm nëse deklaruesit nuk i kujtohet se çfarë ka ndodhur dhe pastaj deklarata e mëhershme mund të shfrytëzohet për të rifreskuar kujtesën e juaj. Ajo gjithashtu mund të shfrytëzohet gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë për të gjykuar deklaratën e dëshmitarit të dhënë në marrje në pyetje të drejtpërdrejt.*

*Pas këshillimit me anëtarët e trupit gjykues:*

*Kryetari i Trupit Gjykues: Unë nuk do të komentoj mbi veprimin e prokurorisë. Sidoqoftë, ne, trupi gjykues, kemi për obligim të ndjekim të vërtetën objektive në këtë rast. Prandaj, ne duhet të bëjmë pyetje për të vërtetuar faktet në këtë rast..<sup>2</sup>*

## **20. Konferenca ne video**

### **a. Arsyetim**

1. Një dëshmitar, C. C., ishte dëgjuar përmes video konferencës për shkak të mungesës së tij në Kosovë.
2. Në atë rast një person zyrtar, C. D., zëvendës prokuror i \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_, ishte i pranishëm në vendin në terren për të garantuar identifikimin

---

<sup>2</sup> Procesverbal I Shqyrtimit Kryesor, 18 gusht 2015, f. 3, l. 35-50;

e saktë të dëshmitarit dhe lirinë e tij për të folur pa qenë i detyruar apo udhëzime të paligjshme.

#### **b. Pajisjet**

1. Pajisjet e përdorura për video konferencë i ka lejuar trupi gjykues dhe gjithashtu i ka lejuar palët në gjykatore për të parë dëshmitarin të ulur në vend në distancë nga beli e më lart. Dëshmitari ishte në gjendje për të parë personin i cili e merrte atë në pyetje dhe kamerën e fokusuar në fytyrë dhe pjesën e epërme të trupit të personit i cili i bënte pyetje. komunikimi audio në të anët në kohën e drejtpërdrejt ishte mbajtur ndërmjet dëshmitarit dhe personave në gjykatore. Zëri ishte sinkronizuar me imazhin. Ekрани në gjykatore ishte i dukshëm për trupin gjykues, palët dhe publikun.

#### **viii. Kundërshtimet e palëve në veprimet procedurale të ndërmarra nga trupi gjykues**

1. Më 27 korrik 2015, avokati mbrojtës Faruk Korenica ngriti kundërshtimin për të përdorur raportet e policisë si prova në këtë rast, duke deklaruar që ato mund të trajtohen si të tilla prandaj dëshmitari nuk mund të ballafaqohet me përmbajtjet e raporteve të tilla. Trupi gjykues vendosi si në vijim:

*"Ne nuk mund të përdorim raportin e policisë si provë direkte dh ene nuk mund të përdorim raportin e policisë si burim për konstatim të faktit, dhe ne nuk mund të*

vërtetohet ndonjë fakt bazuar në raportin por unë e kam të drejtën të ballafaqoj dëshmitarin me çdo provë të pranueshme. Ne nuk konsiderojmë që raporti policor të jetë provë e pranueshme për qëllim të përmbajtjes së tij. Kjo do të thotë për besueshmërinë e fakteve të paraqitura në përmbajtje të tyre. Raporti i policisë vet mund të dëshmoj që zyrtari policor i cili e ka hartuar atë ka paraqitur faktet në mënyrë të tillë ashtu siç është shënuar. Prandaj, raporti i policisë mund të përdoret për të vë në dyshim dëshmitarin apo për të testuar besueshmërinë e tij. Ka faza të ndara të marrjes në pyetje të dëshmitarit në gjykatore, e para është marrja në pyetje direkte, e cila i përket palës që ka ftuar dëshmitarin dhe pastaj vjen marrja në pyetje në mënyrë të tërthortë. Ka rregulla të ndryshme për marrjen në pyetje në mënyrë direkte dhe për marrje në pyetje në mënyrë të tërthortë siç e dimë të gjithë nga ne. Ka shumë kufizime gjatë marrjes në pyetje në mënyrë direkte. Asnjë pyetje sugjестive, pa ballafaqim me provat që mund të kundërshtojnë, dëshmimin e dhënë në gjykatë por këto kufizime nuk aplikohen gjatë marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë. Pyetjet përsëritëse janë të lejuara dhe kështu ato janë pyetje provokative. Ka një çështje ligjore e cila nuk është e rregulluar në kodin e procedurës penale e cila merret me kohën për pyetje të bëra nga trupi gjykues. Ne mund të bëjmë atë në çdo kohë, gjatë marrjes në pyetje në mënyrë direkte apo rimarrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë. Kështu, nëse unë të vendosja të bëja pyetje të cilat janë menduar për marrje në pyetje në mënyrë të tërthortë mund të bëj atë por nuk mund të përdor atë si gjendje faktike apo bazë për gjendjen faktike nëse pyetjet nuk përputhen me rregullat e provave".<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 27 korrik 2015, f. 21;

2. Më 4 shtator 2015, avokati mbrojtës Kaplan Baruti, Dobrica Lazic, Xhelal Hasani, dhe Faruk Korenica kundërshtuan në identifikim të fajtorëve të fotografive të përshkruara që ishin pranuar në prova në rast. Dëshmitari S. S. 1. ishte kërkuar nga kryetari i trupit gjykues të bëj identifikimin e urdhëruar në gjykatore atë ditë. Avokati mbrojtës argumentoi që identifikimi vet nuk përputhej me rregullat procedurale të paraqitura nga KPPRK. Kryetari i trupit gjykues u përgjigj në kundërshtimet në këtë mënyrë:

*"Pas këshillimit ne vendosëm të lejojmë atë. Para se gjithash, nuk ka ndalesë formale procedurale në një identifikim të tillë. Ka rregulla shumë të kufizuara të identifikimit që kanë të bëjnë me procedurën paraprake."*

*Nëse identifikimi, nëse rreshtimi në procedurën paraprake është bërë në shkelje të rregullave të procedurës, atëherë me siguri është e papranueshme. Ka juridiksione të tilla që shprehimisht ndalojnë të ashtuquajturën njohje "në bankë të akuzuarve" , dhe shembulli më i mirë i kësaj është Mbretëria e Bashkuar. Por megjithatë në MB është e lejuar të i lihet çështja në zgjidhje të gjyqësorit. Ne jemi të njohur të gjithë faktorët që kanë mundur të shkaktojnë paragjykim të paanshmërisë së dëshmitarit. Të pandehurit janë ulur në bankë të akuzuarve me avokatin e tyre mbrojtës. Ne kuptojmë çfarë efekti mund të ketë në dëshmitarin. dhe akoma ne jemi gjyqtarë profesionistë dhe ne gjithmonë aplikojmë maturinë tonë për të vlerësuar çdo gjë që thotë dëshmitari. Kështu, ne do të lejojmë këtë njohje "në banke të akuzuarve" dhe ne do të bëjmë vlerësimin tonë nëse ai është bindës."<sup>4</sup>*

---

<sup>4</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 4 shtator 2015, f. 11, l. 1-50;

21. Më 8 shtator 2015, avokati mbrojtës Dobrica Lazic kundërshtoi në pyetjet e bëra nga prokuroria dëshmitares së mbrojtjes A. S., duke argumentuar që Prokuroria po i bën presion dëshmitares. Trupi gjykues vendosi si në vijim:

*"çfarë jeni duke bërë është e ashtuquajtur duke folur kundërshtim. Është një kundërshtim që përbëhet prej përgjigjes që avokati mbrojtës në fakt dëshiron të nxjerr nga dëshmitari. Unë nuk do të ju lejoj të bëni një kundërshtim të tillë. Qëllimi i marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë është për të testuar saktësinë e dëshmitarit. Nganjëherë avokatët mbrojtës janë të lejuar të bëjnë pyetje të cilat ishin bërë dhe përgjigjur por ata nuk mund të bëjnë atë shumë herë kjo mund të qoj në ngacmim të dëshmitarit. Nëse ju po i thoni trupit gjykues që atij dëshmitari iu është presion nga prokurori në marrjen në pyetje në mënyrë të tërthortë, ju e keni të drejtën të ngritni këtë kundërshtim por përgjigja ime është që një shkallë e caktuar e presionit është e lejuar përderisa ajo nuk është e tepruar. Pyetja lejohet."*<sup>5</sup>

#### **ix. Kërkesat e provave refuzohen nga trupi gjykues**

1. Këto kërkesa të provave janë refuzuar nga trupi gjykues:
2. Më 8 shtator 2015, avokati mbrojtës Faruk Korenica bëri një kërkesë me gojë tek trupi gjykues për të ftuar ushtarët e \_\_\_\_\_, të cilët janë të dukshëm në fotografi të njëjtë si klient i tij, për të dëshmuar para trupit gjykues. Trupi gjykues vendosi si në vijim:

*"çështja e parë që erdhi në vëmendjen tonë, është pse kjo kërkesë po vjen aq vonë. Do të na marrë një kohë të*

---

<sup>5</sup> Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 8 shtator 2015, f. 6, l. 5-20;

konsiderueshme për të gjetur ushtarët e \_\_\_\_\_, dhe vështirë se ata janë në mision tani për shkak të rrotacionit, dhe për t'i gjetur ata dhe të bëjmë video lidhje do të jetë shumë e vështirë. Por pasi që ishte me rëndësi për mbrojtjen dhe i pandehuri nuk duhet t'i bart pasojat e veprimeve negative të avokatit të tij, ne do të kërkojmë nga z. Korenica të paraqes kërkesën e tij me shkrim me shpjegim të detajuar. Ne do të donim të dinim pse kjo kërkesë është aq e vonshme. Kjo është detyra e jonë të përjashtojmë kërkesat të cilat janë të paraqitura vetëm për të zgjatur procedurën.

Ne do të donim gjithashtu të mësonim argumentet mbi rëndësinë e Z. Korenicës. Ne kemi shqetësimet tona në vijim sa i përket rëndësisë së provave: dëshmitari S.S.1 dëshmoi rreth disa incidenteve të dhunshme në bllokimin e rrugës së parë. Fotografitë janë marrë më vonë, më sa kuptoj unë, jo vetëm këtë të fundit por gjithashtu në vendet tjera, kështu, ajo në vendin në fakt nuk kishte akte të dhunës të raportuara. Prandaj, çështja e rëndësisë është me rëndësinë më të madhe. Z. Korenica nuk e di se çfarë do të paraqes klienti i juaj në fjalën përfundimtare, por ju lutem na prezanto neve hipotezat. Z. Korenica ju lutem paraqite kërkesën e juaj me shkrim, dhe në fakt unë do të ju kërkoj atë para seancës së ardhshme do të ishte kohë e mjaftueshme për prokurorin të përgjigjet.”<sup>6</sup>

3. Avokati mbrojtës pastaj paraqiti me gojë që kërkesa e tij nuk iu ishte prezantuar më herët trupit gjykues sepse i pandehuri nuk mund të njihej nga fotografitë që ai i kishte parë më herët. Vetëm kur fotografitë ishin rritur për 100 %, i pandehuri tha që ai ishte ai. Prandaj, mbrojtja argumentoi që kërkesa nuk ishte e vonuar. Trupi gjykues vendosi që kërkesa

---

<sup>6</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 8 shtator 2015, f. 13, l. 5-25;

nuk ishte e vonuar por e ftoi avokatin mbrojtës të parashtroj kërkesë me shkrim për të shpjeguar se pse një kërkesë e tillë është me rëndësi. Pas kësaj, avokati mbrojtës nuk parashtroi ndonjë kërkesë.

22. Më 12 tetor 2015, avokati mbrojtës Faruk Korenica dhe Miodrag Brkljac kundërshtuan raportet e policisë që u pranuan si prova në këtë rast. Veç kësaj, bisedat telefonike në listën e provave që prokurori mendon të ketë pranuar si prova në këtë rast nuk mund të jenë prova pasi që asnjë urdhër i gjykatës nuk është lëshuar. Në fund, mbrojtja kundërshtoi dëshmitet e procedurës paraprake të gjithë dëshmitarëve të cilët erdhën për të dëshmuar para trupit gjykues duke qenë të pranuar si prova pasi që të gjithë dëshmitarët gojarisht kanë deklaruar që ata mbesin pranë deklaratave të tyre. Trupi gjykues vendosi si në vijim:

*"Para se gjithash, kundërshtimet në raportet e policisë.*

*Avokati mbrojtës argumentoi që raportet e policisë në fakt zëvendësojnë deklaratat e dëshmitarit. Ne erdhën në këtë përfundim: së pari, sipas përkufizimit të dhënë nga KPRK, raporti i policisë është informatë rreth provave të mbledhura në rast. Pasi që është informatë rreth provave nuk do të konsiderohet si provë në vetë. Ky është një interpretim fjalë për fjalë i gjuhës së ligjit të përdorur nga ligjvënësit kosovarë. Sidoqoftë, nëse ne shkojmë në përmbajtje, në detaje të përmbajtjes së raportit të posaçëm, ai zakonisht përbëhet prej informatave që i përkasin kategorive të ndryshme të informatave. Dhe ne do të pajtoheshim me avokatin mbrojtës që nëse raporti citon informatat e marra nga personi që ka vëzhguar ngjarjen apo faktet relevante për rastin, së pari ky person duhet të konsiderohet si dëshmitar në rast, dhe së dyti kjo kap një regjim të*



veçantë të ruajtjes së informatave që rrjedhin nga ky person.

Ka mbrojtje të caktuar të cilat duhet të vëzhgohen me qëllim të që vijnë nga dëshmitari i pranueshëm. Personi duhet të informohet në lidhje me pasojat të dëshmimit të gabuar, pastaj regjistrim i duhur duhet të ndërmerret, dhe pastaj kjo varet se çfarë standardi i veprimit ishte aplikuar. Kjo varet nëse informata ishte zbuluar në intervistë të procedurës paraprake, dëshmim të procedurës paraprake, apo mundësia e hetimit të veçantë dhe kjo varet në formën që është ruajtur informata, çfarë përdorimi mund të kemi në shqyrtim kryesor. Thjesht, me fjalë të tjera, që vijnë nga një person i cili duhet të konsiderohet dëshmitar nuk mund të paraqitet në gjykatë në ndonjë formë tjetër sesa ajo e përmendur në nenin 123 të KPPK.

Duke u kthyer në përmbajtjen e raportit policor, përveç kësaj kategorie të informatave për të cilat unë tashmë kam komentuar, ka gjithashtu informata që janë të bazuara në shënime të zakonshme, rutinore të operimit të policisë dhe këto janë shënime që janë bërë në bazë rutinore, në lidhje me çdo veprim të marrë gjatë operacionit normal të policisë. Kështu, këto janë shënimet e ndërrimeve, të veturave të përdorura, të numrit të regjistrimit të veturave të përdorura nga \_\_\_\_\_, këto janë shënimet e komunikimit normal ndërmjet \_\_\_\_\_ dhe dhomës së operatives, ato në mënyrë tipike janë mbledhur dhe jo për qëllim të ndonjë ngjarje të veçantë që mund të konsiderohet krim. Ka një supozim që rregullat e brendshme të organizimit, sikurse forcat policore janë konsideruar të jenë, që këto rregulla të procedurës parandalojnë informatat për të qenë disi të shformuara apo të shkelura. Nëse shikojmë në sistemin e zakonshëm të

ligjit, i cili është disi, Ligji Penal i Kosovës i referohet konceptit të sistemit të përgjithshëm ligjor, ne atje kemi të bëjmë me shkarkime të thashethemeve, të i referohen shënimit normal të biznesit.

Në sistemin e përgjithshëm ligjor, thashethemet në përgjithësi nuk janë të papranueshme, dhe thashethemet janë informata të cilat nuk vijnë nga burimi origjinal, që do të thotë për shembull që dëshmitari është i ndërlidhur me rrëfimin që ai ka dëgjuar nga një person tjetër. Normalisht shënimi i punës, nëse dikush i kujton shënimet si provë. Ne nuk duhet të thërrasim dëshmitarin pasi që ka supozim që shënimi/procesverbali është bërë në mënyrë të duhur. E bën një punë rutine të pranueshme. Natyrisht, besueshmëria e tij mund të sfidohet por të flasim në përgjithësi ajo është e pranueshme. Të kthehemi tek raporti policor i paraqitur nga prokurori, ne e gjejmë të papranueshëm pjesët e atyre shënimeve të përbëhen nga deklaratat e dëshmitarit por ne e gjejmë si të pranueshme sa i përket fakteve aktuale të shënimeve si operacion normal i policisë.

Grupi tjetër i provave që ishte lëndë e kundërshtimeve të paraqitur nga avokati mbrojtës Miodrag Brkljac, janë provat të cilat ishin nënvizuar nga prokurori si dëshmime. Këto janë intervista të dëshmitarit të M. A., intervista e dëshmitares D. R. 1., G. J., por gjithashtu marrja në pyetje në procedurë paraprake e dëshmitarit M. S., C. C., G., etj.

Ne i deklarojmë të papranueshme të gjitha provat të cilat përbëhen prej deponimet e dëshmitarëve në përjashtim të deklaratave të procedurës paraprake që tashmë janë paraqitur në gjykatë gjatë shqyrtimit kryesor, që do të

thotë gjatë marrjes në pyetje direkte apo në mënyrë të tërthortë dëshmitarëve. Dhe unë tashmë kam dhënë shpjegim pse ne konsiderojmë që zëvendësimi i dëshmitarit në gjykatë me deklaratë të tij me shkrim nuk lejohet sipas KPPK.”<sup>7</sup>

23. Veç kësaj, më 12 tetor 2015, avokati mbrojtës Miodrag Brkljac kundërshtoi vlerën e përgjithshme të dëmeve të pësuar nga \_\_\_\_\_ pas incidenteve pasi që raportet e tilla ishin hartuar nga vet \_\_\_\_\_, pala e cila ishte dëmtuar. Trupi gjykues vendosi si në vijim:

"Pastaj, ne kemi dokumente të cilat përbëhen prej përshkrimeve të dëmeve. Këto janë dokumentet të hartuara nga zyrtarët policorë për qëllim të procedurës penale që paraqet vëzhgimet e tyre dhe në fakt kjo është natyra e dokumentit të tillë është e shumë e ngjashme me raportin e kontrollit apo raportin e inspektimit. Normalisht ne nuk marrim në pyetje personat të cilët kanë kryer kontrollin apo inspektimin për të marrë informatat çfarë ata kanë vëzhguar apo vërejtur dhe dallimin ndërmjet dëshmimit të zyrtarit policor dhe raportit mbi inspektimin e vendit të ngjarjes apo objektit është i qartë. Deklaratat i referohen fakteve që kanë ndodhur para se të fillonte hetimi. Faktet e paraqitura në vend të ngjarjes apo në inspektim të objektit dhe në këtë rast në dëmet e vërejtura, ishin hartuar gjatë procedurës nga zyrtari i autorizuar i policisë pasi që kjo ishte detyra e tij për të mbledhur dhe ruajtur këtë provë. Kështu, është e pranueshme edhe pse natyrisht besueshmëria e tij mund të kundërshtohet.”<sup>8</sup>

"prova e fundit e kontestueshme nga avokati mbrojtës ka të bëjë me vlerën e përafërt të dëmeve dhe ne jemi pajtuar me

---

<sup>7</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 12 tetor 2015, f. 4-5;

<sup>8</sup> Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor, 12 tetor 2015, f. 5, l. 30-40;

avokatin mbrojtës Miodrag Brkljac që kjo provë nuk i plotëson standardin e dëshmisë që nevojitet nga gjykata sepse është vështirë bile për të caktuar vlerësimin e dëmeve. Në lidhje me pikën e cila është e shënjuar si pika A në aktakuzën e ndryshuar, kjo e cila është e ndërlidhur vetëm me S. S., si Z. S. V. po pret për procedurë të ndarë, ka diçka që duket si faturë por është në tërësi e palexueshme. Ne nuk mund të lexojmë këtë kopje të faturës dhe nuk mund të shohim se çfarë ka aty. Ne bile nuk mund të shohim se prej nga vjen, nga \_\_\_\_\_ apo nga përfaqësuesi i automjetit, nëse ajo është shuma që \_\_\_\_\_ ka paguar, që do të thotë që ne nuk kemi dyshim në përmbajtje. Ne nuk mund të lexojmë përmbajtjen e dokumentit. I njëjti është i ndërlidhur me raportin e dëmit tjetër. Nuk ka vlerësim të shpenzimit që është i nevojshëm për akuzat. Prandaj, ne kemi vendosur ex officio, të kërkojmë faturat për riparim të dëmeve të paguara nga \_\_\_\_\_ dhe pastaj ne do të vendosim të marrim një dëshmitar ekspert për të shpjeguar më tepër çështjen por zakonisht në praktikën gjyqësore shuma e e riparimit paraqet dëmet aktuale që janë element i krimit apo ato të pësuara nga pala.”<sup>9</sup>

24. Veç kësaj, Avokati mbrojtës Miodrag Brkljac gjithashtu kundërshtoi fotografitë e marra nga \_\_\_\_\_ i \_\_\_\_\_ gjatë incidenteve të pranuar si prova sepse ato ishin marrë pa pëlqim të personave të pranishëm në fotografi. Trupi gjykues vendosi si në vijim:

“Pastaj ne vijmë tek fotografitë e marra nga \_\_\_\_\_ në vendin e krimit para se hetimit të fillonte. Në atë rast \_\_\_\_\_ vepruan si çdo anëtar i publikut, si dëshmitar, dhe \_\_\_\_\_ nuk kishte nevojë për ndonjë autorizim të veçantë. Nëse \_\_\_\_\_ është

---

<sup>9</sup> Procesverbali i Shqyrtimit Kryesor, 12 tetor 2015, f. 6, l. 1-15;

dëshmitar në krimin që është kryer dhe ai vëzhgon se çfarë po ndodh, dhe në fakt është detyrë e tij të vëzhgoj se çfarë është duke ndodhur, ne nuk duhet të privojmë atë nga mundësia për të ruajtur këtë informatë për hire të procedurës si çdo qytetar tjetër që mund të bënte. Këtu është çështja e vërtetimit, që do të thotë origjinën e fotografive, por kjo nuk bie mbi çështjen e pranueshmërisë por besueshmërisë apo saktësisë. Ne e kemi dëgjuar dëshmitarin S.S.1 duke na treguar neve kur ai mori fotografitë, dhe në fakt si mbrojtës e vërejta, ato janë marrë në momentin kur situata ishte e qetë. Ato nuk tregojnë ndonjë akt të dhunës por pa hyrë në detaje të përmbajtjeve të fotografive pasi që ajo do të i nënshtrohet vlerësimit nga trupi gjykues gjatë këshillimit, ne deklarojmë fotografitë si të pranueshme.

Pastaj, fotografitë e dëmeve të pësuar nga automjetet, ne e konstatojmë këtë si të pranueshme sikurse çdo zyrtar policor është i lejuar të bëj fotografi të vendit të inspektimit apo objektit të inspektimit apo vendeve apo objekteve të cilat i nënshtrohen kontrollit.”<sup>10</sup>

25. Avokati mbrojtës Brkljac gjithashtu kundërshtoi të ketë dëshmimet e procedurës paraprake të pandehurve të cilat janë pranuar si prova. Kryetari i trupit gjykues komentoi si në vijim:

"unë kam harruar rreth një çështje që ishte cekur nga avokati mbrojtës Miodrag Brkljac. Kjo është përdorimi i deklaratës së procedurës paraprake të dhënë nga të pandehurit. Në këtë moment ne e refuzojmë kërkesën e prokurorit që të konsiderohet ajo si e lexuar sepse ka një regjim të veçantë mbi përdorimin e deklaratave të procedurës paraprake të dhëna nga të pandehurit. Kështu, kur koha e dëshmimeve të pandehurve do të

---

<sup>10</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 12 tetor 2015, f. 5-6;

vinte, ne do të vendosim rast pas rasti dhe në çfarë mase të dëshmimeve të procedurës paraprake mund të përdoren.”<sup>11</sup>

## II. Vërtetimi i gjendjes faktike

1. Faktet relevante në pikat e akuzës që të pandehurit janë gjykuar në këtë rast janë vërtetuar nga trupi gjykues në bazë të analizave dhe vlerësimit të gjitha provave materiale të ekzaminuara në gjykatore.
2. Më \_\_\_\_ konvoji që përbëhej prej një automjeti të \_\_\_\_\_ dhe 3 automjeteve të \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ -\_\_\_\_-\_\_\_\_, \_\_\_\_-\_\_\_\_-\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_-\_\_\_\_-\_\_\_\_ shkuan nga \_\_\_\_\_ e \_\_\_\_\_ në drejtim të Portës \_\_\_\_\_. Automjetet ishin Toyota Landcruiser i llojit \_\_\_\_ (\_\_\_\_). Kishte \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ së \_\_\_\_\_ në automjete: J. R., A. W., D. D., S. S. 1. dhe T. A.. Ata ishin urdhëruar të paraqiteshin në portën \_\_\_\_ për shkak të vizitës së Drejtuesit të \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_.
3. Në ora \_\_\_\_:\_\_\_\_ konvoji ishte duke kaluar në një vend ku një rrugë e improvizuar e bllokimit të rrugës afër fshatit \_\_\_\_\_ zakonisht ishte aranzhuar. Bllokimi i rrugës nuk ishte autorizuar nga ndonjë autoritet kompetent. Në këtë kohë nuk kishte pasur njerëz duke bllokuar rrugën. Në këtë moment **B. J.** iu ofruar automjetit \_\_\_\_-\_\_\_\_-\_\_\_\_ vozitur nga T. A. dhe me qëllim theu pasqyrën e majtë të automjetit. Vlera e dëmit të shkaktuar nga ai ishte 599.14 euro<sup>12</sup>.
4. Konvoji nuk u ndal por vazhdoi në drejtim të portës \_\_\_\_\_. Gjatë rrugës ishte tejkaluar nga 4 vetura. Rreth orës \_\_\_\_:\_\_\_\_, rreth \_\_\_\_\_

<sup>11</sup> Procesverbal i shqyrtimit kryesor, 12 tetor 2015, f. 6, l. 25-30;

<sup>12</sup> Shih Toyota "Para llogarinë" në automjetin \_\_\_\_\_, të datës 4 prill 2012;

4 km nga \_\_\_\_\_, afër \_\_\_\_\_, konvojit ishte bllokuar nga 4 vetura. Ato ishin parkuar në rrugë dhe atje kishte 8 persona duke qëndruar rreth atyre veturave. Konvoji u ndal tek bllokimi i rrugës. Po vinin më shumë njerëz në vend por për për afërsisht 45 minuta situata ishte e qetë dhe nuk ndodhi asnjë akt i dhunës. Rreth orës \_\_:\_\_ një grup për afërsisht prej 21 deri në 31 persona u bë shumë agresiv ndaj anëtarëve të konvojit të \_\_\_\_\_. Ata ishin S. S., B. J., S. V. (ky i fundit nuk mori pjesë në shqyrtim), dhe personat e tjerë të cilët nuk ishin identifikuar gjatë shqyrtimit. Turma u bë shumë agresive dhe rreth orës \_\_:\_\_ pjesëmarrësit hodhën gurë në drejtim të automjeteve të \_\_\_\_\_. Një njeri i paidentifikuar ndërhyri tek gomat e automjeteve por nuk shkaktoi ndonjë dëm. Dikush vuri një çantë ndërmjet automjeteve. S. S., shkëlmoi dhe e theu pasqyrën e majte të pasme të automjetit të \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_ vozitur nga S. S. 1.. Ai gjithashtu grabiti një dritë të gjelbër mbi automjet të \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_ vozitur nga T. A. dhe e shkatërroi atë duke e thyer atë kundrejt dritares së pasme të automjetit. \_\_\_\_\_ vendosën të largohen nga skena dhe u tërhoqën. Veprimet e përshkruara shkaktuan dëm në pasurinë e \_\_\_\_\_ në shumë prej 1,419.93 eurove.<sup>13</sup>

5. Më \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ C. C., M. S. dhe M. B. morën një urdhër të \_\_\_\_\_ të kontrollojnë lëvizjen e lirë në \_\_\_\_\_. Ata udhëtuan atje nga Mitrovica me automjete të \_\_\_\_\_ Toyota Landcruiser të llojit \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_ - \_\_\_\_\_. M. S. ishte vozitësi. Në ora \_\_:\_\_, ata erdhën në vendin afër fshatit \_\_\_\_\_. Kishte pasur bllokim të

<sup>13</sup> Shih "Dëmtimi I automjetit të \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_, Rasti me nr. MIT 1594/2012; Dëmi i automjeteve të \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ Rasti nr. PR1432A/12/4/3" i datës 14 tetor 2015;

rrugës të improvizuar që përbëhej prej 8 deri në 10 persona. Bllokimi i rrugës nuk ishte i autorizuar nga ndonjë autoritet kompetent. Automjeti ishte ndalur nga ata për disa sekonda por menjëherë ishte lejuar të kalonte.

6. Kur \_\_\_\_\_ mbërritën në qendër të \_\_\_\_\_ një automjet i bardhë i llojit të vagonit të stacionit ishte duke qëndruar në rrugë dhe duke e bllokuar atë. Automjeti i \_\_\_\_\_ u ndal. Kishte një grup të rreth 100 infermiereve të mbledhura në afërsi të ndërtesës komunale por ata nuk iu ofruan automjetit të \_\_\_\_\_. Menjëherë pasi që u ndal automjeti i \_\_\_\_\_ ai ishte rrethuar nga një turmë prej 13 deri në 18 persona, duke përfshirë S. S. dhe S. V.. Ata kishin të vendosur kapela dhe kishin mbuluar fytyrat e tyre. Disa nga ata hodhën gurë në drejtim të automjetit. S. V. e hodhi ngjyrën. S. S. e shkelmoi një pasqyrë të jashtme të pasme dhe e goditi karroserinë e automjetit dhe dritaret e tij me një çekan disa herë. Veprimet e kryera nga pjesëmarrësit së turmës duke përfshirë S. S. kanë zgjatur për afërsisht dy minuta. Si rezultat i karrocërisë, dy pasqyra të jashtme me pamje të jashtme, dritarja e pasme dhe dritat e pasme ishin dëmtuar. Vlera e përgjithshme e dëmit ishte 8,500.20 euro<sup>14</sup>. Një njeri i paidentifikuar duke vënë shkurë poliuretani në periskop të mjetit kështu duke e ngulfatur motorin. M. S. ia doli të ri-startonte motorin dhe të zbraps automjetin nga skena në drejtim të portës \_\_\_\_.

### III. Vlerësimi i provave

<sup>14</sup> Shih "Dëmi i automjetit të \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_, Lënda Nr. MIT 1594/2012; Dëmi i automjeteve të \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ Lënda nr. PR1432A/12/4/3" i datës 14 tetor 2015;



a. Provat e përdorura si bazë për rikonstruim të fakteve

i. Provat në tërësi të besueshme

1) Dëshmitet e dëshmitarëve S. S. 1., C. C. dhe M. S.

1. E shumta e gjendjes faktike e bërë nga trupi gjykues ishte bazuar në dëshmitet e dëshmitarëve S.S.1, C. C. dhe M.S..
2. Ishte e qartë që ata ishin me përvojë në vëzhgim dhe në dhëniet e versionit preciz dhe të strukturuar të ngjarjeve që ata kishin dëshmuar. Deklaratat e tyre përmbanin disa mungesa jo të rëndësishme dhe zbrazëtira të cilat ishin atribuar nga trupi gjykues në kufizim të dukshëm të kujtesës së dëshmitarëve dhe këshillimin mashtrues.
3. Dëshmimi i S.S.1 u paraqit si provë mashtruese për rikonstruim të fakteve që kanë ndodhur afër \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_ dëshmoi në mënyrë të hapur, spontane, pa iu shmangur përgjigjeve në ndonjë pyetje të bëra nga palët dhe nga trupi gjykues. Dëshmimi i tij në gjykatë nuk ishte kundërshtuar nga ndonjë mospërputhje në marrjen e tij në procedurë paraprake. Faktet që \_\_\_\_ i ka paraqitur ishin në përputhje me shënimet e operacionit rutine të \_\_\_\_\_ të paraqitur në raport të \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_ \_\_\_\_ .
4. Nuk kishte dyshim sa i përket njohjes së B. J. dhe S. S. nga S.S.1. Ai i identifikoi ata si pjesëmarrës të ngjarjeve të datës \_\_\_\_ \_\_\_\_ . Dëshmimi i \_\_\_\_ përbëhet me fotografitë që \_\_\_\_ i mori në skenën e krimit në kohën kritike.

5. Dëshmitet e dëshmitarëve C. C. dhe M. S. bënin komplimente njëri tjetrit dhe nuk kundërshtonin njëri tjetrin. Dëshmitet ishin konfirmuese reciprokisht në lidhje me elementet esenciale. Kishte pasur disa mospërputhje të vogla ndërmjet dëshmimeve të C. C. dhe M. S. në lidhje me rrethanat të cilat janë të ndërlidhura me bllokimin në rrugë në \_\_\_\_\_ dhe numrin e pjesëmarrësve të ngjarjeve. Mospërputhjet ishin me rëndësi të pakët dhe duken të jenë si rezultat i papërsosurisë e kujtesës njerëzore. Versioni i prezantuar nga M. S. ishte më tepër bindës pasi që ajo ishte e qartë që ky dëshmitar i rimerrte ngjarjet me më tepër detaje sesa dëshmitari tjetër që bëri. Prandaj, dëshmitet e përmendura ishin pranuar si të vërteta.
6. Numri i pjesëmarrësve të turmës që sulmoi automjetet e \_\_\_\_\_ it më datën \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ ishte vërtetuar duke arritur në një mesatare të raportimeve të numrave nga dëshmitarët e përmendur.

## 2) Raportet policore

1. Trupi gjykues i gjeti të gjitha raportet policore të datës \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_, si të pranueshme dhe të besueshme. Sidoqoftë, vetëm përmbajtja e tyre përbën informatat e tilla si shënimet e ndërrimeve dhe treguesi i veturave të përdorura nga \_\_\_\_\_ ishte pranuar në prova. Gjykata aplikoi një supozim që rregullat interne të organizimit të \_\_\_\_\_ së \_\_\_\_\_ i parandaloi informatat nga shformimi apo shkelja. Nuk kishte pasur mospërputhje ndërmjet raporteve dhe dëshmimeve të M.S., C. C. dhe S.S.1 që do të mund të kundërshtonin këtë supozim.

### **3) Fotografitë**

1. Fotografitë të cilat janë në faqet 2120 to 2162, 2165, 2164, 2118, dhe 2119 të dosjes së lëndës ishin pranuar nga trupi gjykues si në tërësi të besueshme. Ato ishin të gjitha të vërtetuara nga S.S.1. \_\_\_\_\_ konfirmoi vendin dhe kohën se ku ato ishin marrë, dhe nuk kishte pasur tregues që ato të mund të jenë ndryshuar.

### **4) Faturat për riparimet e automjeteve të \_\_\_\_\_**

1. Nuk kishte pasur dyshime sa i përket besueshmërisë së faturave për riparim të automjeteve të \_\_\_\_\_, dhe informatave mbi dëmin e mëparshëm që nuk janë të ndërlidhura me rastin ishte bërë nga Departamenti i Transportit të \_\_\_\_\_-it në raportin e datës 14 tetor 2015. Faturat ishin lëshuar nga kompania e cila i ka kryer riparimet gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm të punës. As njohuria e përgjithshme e as faktet e vërtetuara në rast nuk kanë treguar për vlerësim negativ të përmbajtjes së dokumenteve të përmendura.

#### **ii. Faktet e njohura të miratuara nga trupi gjykues**

1. Trupi gjykues pranoi atë si një fakt të njohur që bllokimet rrugëve të improvizuara nuk ishin të autorizuara nga ndonjë autoritet kompetent.

#### **iii. Provat e besueshme por jo bindëse**

1. Trupi gjykues pranoi dëshmitet e dhëna nga M. A., D. R. 1 dhe G. J. si të besueshme. Ato nuk përmbanin elemente të cilat kundërshtonin provat tjera të besueshme në rast. Sidoqoftë, ato nuk përmbanin fakte që do të mund të tregonin fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit. E as nuk përmbanin ato faktet që do të mund të vërtetonin apo të mohonin një provë të tillë.
  
2. Trupi gjykues konsideroi dëshmimin e dhënë nga M. K. si të besueshëm. Dëshmitari nuk kundërshtoi faktet e vërtetuara në bazë të provave të tjera. Në të njëjtën kohë sidoqoftë vëzhgimet e \_\_\_\_\_ dhe kujtesën e serishme të fakteve ishin sipërfaqësore dhe pa detaje. Dëshmitari ishte dukshëm jo i gatshëm të bëj ndonjë përpjekje të rikujtoj ngjarjet në mënyrë të saktë.

**iv. Provat e refuzuara si bazë për rikonstruim të fakteve**

1. Trupi gjykues gjeti dëshmitet e S. S., A. S., S. V. 1. dhe K. V. jo bindëse versionet e ngjarjeve të paraqitura nga të akuzuarit dhe nga dëshmitarët e përmendur ndryshojnë në lidhje me gjendjen shëndetësore të së bijës së të akuzuarit në kohën kritike. Sipas A. S., e bija e të akuzuarit S. S. ishte e sëmurë dhe ajo kishte ethe, përderisa S. V. 1. dëshmoi që e bija ishte e shëndoshë por ajo refuzoi të shkonte në kopsht. Të dyja A. S. dhe S. V. 1. punojnë si (apo 'janë') infermiere, kështu kujtesa e tyre e simptomave të ndonjë sëmundje të pretenduar duhet të jetë e saktë. Sipas K. V., fëmija kishte ethe të larta, kështu që nevoja për ndihmë e S. V. 1. ishte urgjente. Kjo nuk ishte konfirmuar nga fare nga S. V. 1.. Në lidhje me këtë çështje, përgjigjet e dhëna nga

K. V. në marrjen në pyetje u paraqit si e paqartë dhe jo e singertë. Për këto arsye trupi gjykues vlerësoi që të akuzuarit dhe dëshmitarët kanë sajuar versionet e tyre me qëllim të ofrimit të \_\_\_\_\_ me alibi të rremë.

2. Trupi gjykues konstatoi dëshmimin e dhënë nga S. S. jo të besueshëm. Versioni i tij ishte kundërshtuar nga provat e tjera të përmendura të cilat plotësojnë njëra tjetrën. Në veçanti pretendimet e S. S. që ai ishte provokuar nga sjellja e rëndë e \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ nuk ishte mbështetur nga ndonjë provë e besueshme.
3. Trupi gjykues konstatoi që raporti i policisë i hartuar më datën \_\_\_\_\_ ai ishte gjoja i përgatitur nga M. K. jo i besueshëm. Përkundër datës, raporti i cili i referohet ngjarjeve të datës \_\_\_\_\_. M. K. mohoi që ai e ka shkruar atë. Prandaj vërtetësia e këtij raporti nuk ishte konfirmuar dhe përmbajtja e dokumentin vet mund të verifikohet.

#### **IV. Identiteti subjektiv i aktgjykimit i cili mbizotëron mbi aktakuzën**

1. Për shkak të parimit të identitetit subjektiv të aktgjykimit mbi aktakuzën, krimet që janë atribuar të akuzuarve janë përshkruar pa tregues të kryerësit i cili nuk ka marrë pjesë në seancë, do të thotë S. V.. Në vend të emrit të tij dispozitivi i aktgjykimit i referohet një personit tjetër të identifikuar. Çdo konstatim i trupit gjykues në lidhje me S. V. të cilat ishin bërë në këtë rast nuk mund të përdoren si bazë për vendim në ndonjë procedurë tjetër.

## V. Klasifikimi ligjor i veprimeve të atribuar të akuzuarve

### a. Klasifikimi ligjor i veprimit të akuzuarit

1. Sipas nenit 360, paragrafët 2 të KPPRK, klasifikimi ligjor i akuzave të paraqitura nga prokurori nuk ishin detyruese për trupit gjykues. Trupi gjykues e mori parasysh ndryshimin e ligjit material i cili është bërë pas kohës së kryerjes së krimeve dhe para kohës së dënimit. Veprimet që trupi gjykues i ka atribuar të akuzuarve ishin kryer më \_\_\_\_ dhe \_\_\_\_, që do të thotë para hyrjes në fuqi të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) të datës 20 prill 2012 që ka ndodhu më 1 janar 2013. Trupi gjykues krahasoi dispozitat ligjore të parapara me ligjin në fuqi në kohën e kryerjes me ligjin e ri që ishte në fuqi prej asaj kohe deri në dënim. Megjithatë përkufizimet e krimeve që janë atribuar tek i akuzuari paraqiten si të njëjtë në të dy kodet, sanksionet e parapara për veprat e njëjta në ligjin e ri duket të jenë më të rënda sesa në "kodin e vjetër", do të thotë në Kodin Penal të Kosovës të 6 nëntorit 2008. Në veçanti, dënimi për sulm mbi personin apo lirinë e Kombeve të Bashkuara apo personelit të ndërlidhur me të i cili është penalizuar sipas nenit 174, paragrafi 2 i kodit të "ri" dhe sipas nenit 142, paragrafi 2 i kodit të "vjetër" është i dënueshëm me kod të "ri" me burgim prej tre deri në dymbëdhjetë vjet përderisa ishte dënuar me burgim nga një deri në dhjetë vjet në kodin e "vjetër".
2. Pasi që rregullat e dënimit sipas të dy kodeve nuk ndryshon nga njëri tjetri, dënimi i caktuar sipas ligjit të ri in concreto do të duhej të ishte më i rëndë. Prandaj, sipas nenit 3, paragrafi 2 i KPRK, ligji "i vjetër" është aplikuar si më i favorshëm.

3. Trupi gjykues mori parasysht që veprime e kryera nga S. S. dhe B. J. në të dy ditët kritike kanë plotësuar karakteristikat e disa krimeve.
4. Në të dyja rastet ata kanë vepruar në bashkëkryerje me personat e tjerë. Kishte pasur disa fajtorë që vepronin në mënyrë simultane. Veprimet e tyre plotësonin përkufizimin e bashkë kryerjes bazuar në nenin 23 të KPK:

*Kur dy apo me tepër persona se bashku kryejnë veprë penale duke marrë pjesë në kryerje të veprës penale apo kryesisht duke kontribuar në kryerje të saj në ndonjë mënyrë tjetër, çdo njëri nga ata do të jetë përgjegjës dhe dënohet siç është paraparë për veprën penale.*

5. Çdo veprim individual i ndërmarrë nga secili person ishte bërë në praninë të autorëve të tjerë të krimit. Çdo autor i krimit ka marrë përsipër për veprimet e kryera nga tjetri. Çdo veprim i çdo individi i ndërmarrë nga çdo fajtor individual i ka mbushur mendjen tjetrin për të bërë të njëjtën. Kjo do të thotë që ata kanë vepruar *cum animo socii* që do të thotë ata kanë mbështetur njëri tjetrin në mënyrë domethënëse dhe prandaj ata janë përgjegjës për veprimin e njëri tjetrit.
6. Në teorinë e ligjit, një veprim human është i kuptuar në mënyrë të zakonshme si pasojë e lëvizjeve të kryera me qëllim apo vetëm si një mangësi për të vepruar. Duke e ditur nëse një fajtor ka kryer vetëm një dhe jo disa vepra, kjo zakonisht përcaktohet nga disa faktorë: koha dhe vendi i veprimit të tij apo heqja dhe ekzistimi i qëllimit të vetëm që ka drejtuar të gjitha këto veprime apo lëshime.

7. Në nenin 71 të KPK, ligjvënësi kosovar ka shprehur konceptin që një vepër mund të përbëj disa vepra. Ky koncept është i njohur si marrëveshje ideale e krimeve.
8. Kryetari i trupit gjykues ka shpjeguar esencën e klasifikimit të krimeve në marrëveshje ideale në këtë mënyrë, pas shpalljes së dispozitivit të aktgjykimit:

*"së pari, duhet të thuhet që Ligji kosovar parasheh për të ashtuquajturën "marrëveshje ideale" të krimeve. Ai thotë që veprimet e njëjta mund të klasifikohen sipas dispozitave ligjore si krime të ndara. Kjo quhet si "marrëveshje ideale". Në teori të ligjit ka zgjidhje të tjera në situatën kur një veprim përshtat përkufizimin të krimeve të ndryshme, sikurse multi klasifikimi, apo klasifikimi komulativ. Në disa sisteme të tjera, një vepër është vetëm një krim. Ekzistojnë disa rregulla të përjashtimit të cilat na tregojnë neve pse ne përjashtojmë disa dispozita nga klasifikimi ligjor. Ajo më e rëndësishmja e rregullave i referohet të ashtuquajturës "me e vogël e përfshirë në vepër".*

*"[...] ka një teori të plotë që na tregon neve pse ne aplikojmë disa dispozita njëkohësisht dhe pse ne konsiderojmë që disa dispozita janë të konsumuara nga të tjerët."<sup>15</sup>*

*"[...] problemi fillon nga pyetja fundamentale: a mund të ekzistoj atje veprim kriminal që bie nën përkufizimin ligjor të dy krimeve të ndryshme përderisa në të njëjtën kohë ka krim që bie nën klasifikimin e tjetër të këtyre krimeve?*

---

<sup>15</sup> Procesverbali i shpalljes së aktgjykimit, 23 tetor 2015, f. 3, l. 1-7 dhe l. 12-13;



Nëse përgjigja është "po", ne mund të themi që ka një ndërprerje ndërmjet dy krimeve. Nëse përgjigja është, "jo", ne themi që ka një veçim të krimeve. Të marrim një shembull që ne kemi një rast të rrezikimit të personelit të KB, dhe një krim tjetër të pengimit të personit zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare. Të supozojmë që ne kemi një gjyqtar të KB duke dëgjuar një rast në gjykatore duke qenë viktimë e të dyjave krimeve për shkak se fajtori ka hedhur një gurë dhe ka goditur atë gjyqtar në kokë. Së pari, ky është rrezikim i personelit të KB, pastaj ka gjithashtu pengim të personit zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare sepse gjyqtari është një person zyrtar. Në shembullin e dytë të kemi një pastrues duke qenë anëtar i stafit të KB i cili është goditur me gur të hedhur nga fajtori. Autori i krimit ka rrezikuar personelin e KB, por ai nuk ka penguar personin zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare. Kjo tregon që fushëveprimi i rregullores i të dyja krimeve, janë në lidhje me ndërprerjen.

Të marrim një shembull tjetër: nëse ju e keni një gjyqtar kosovar i cili nuk është anëtar i personelit të KB duke qenë viktimë e gurit të hedhur ne do të merreshim vetëm me pengimin e personave zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare, me kusht që gjyqtari është duke i kryer detyrat. Ne mund të shohim që asnjëri nga krimet nuk konsumon tjetrin.

Gjithashtu pengimi i personave zyrtar mund të përbëj sulm kundër personit por jo domosdo. Për shembull: nëse autori i krimit vjen në zyre të gjyqtarit dhe ai refuzon të

*largohet, ai e pengon atë në kryerje të detyrave të tija gjyqësore por ai nuk është duke e sulmuar atë?"<sup>16</sup>*

9. Trupi gjykues arriti në përfundim që veprimet e atribuuara **S. S.** të kryera nga ai në qendër të \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_ kanë përbërë një vepër penale siç ishin duke e kryer ata në të njëjtën kohë dhe vend, dhe qartë në realizim të planit të njëjtë, dhe prandaj me qëllim të njëjtë.
10. Për arsyet e njëjta veprimet e atribuuara **S. S.** dhe **B. J.** të cilat ishin kryer nga ata afër \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_ ishin konsideruar gjithashtu një vepër penale.
11. Të dy nga këto veprime ishin kryer në bashkë kryerje me personat e tjerë.
12. Ngjashëm veprimet e atribuuara **B. J.** të cilat ishin kryer nga ata afër \_\_\_\_\_ më \_\_\_\_\_ ishte konsideruar gjithashtu si një vepër penale, por në këtë rast ai ka vepruar vetëm.
13. Të gjitha veprat e përmendura penale kanë plotësuar elementet përbërëse të disa krimeve të penalizuara nga KPK që nuk e konsumojnë njëri tjetrin:

- Rrezikimi i Kombeve të Bashkuara dhe Personelit të ndërlidhur me të sipas nenit 142, paragrafi 2; sulm mbi veturën me një personel të tillë është gjithmonë i drejtuar kundër një personi. Duhet të shpjegohet që krimi sipas nenit 142, paragrafi 3 nëse drejtohet kundër automjetit duhet të përbëhet prej sulmit të një automjeti të zbrazët - për shembull dëmtimi i veturës që privon një person i cili i përket Personelit të Kombeve të Bashkuara

---

<sup>16</sup> Procesverbal I shpalljes së aktgjykimit, , 23 tetor 2015, p. 3, l. 19-43;

apo personelit të ndërlidhur me të, të mundësisë për të ikur nga kushtet e rrezikshme të motit që rrezikojnë jetën e tij;

- Pengimi i personit zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare sipas nenit 316, paragrafët 1 dhe 3; \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ janë persona zyrtarë pasi që ata bien në përkufizimin e dhënë në nenin 107, paragrafi 1, nën paragrafët 2 dhe 5. Ata ishin në kryerje të detyrës së tyre. Krimi nuk është konsumuar nga krimi i rrezikimit të personelit të Kombeve të Bashkuara dhe Marrëdhënieve me to pasi që ky krim i dytë mundet gjithashtu të drejtohet kundër anëtarëve të personelit që nuk janë në kryerje të detyrave zyrtare në kohën e sulmit;

- Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare sipas nenit 317, paragrafi 1; ky krim nuk është konsumuar pengim i personit zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare pasi që krimi i dytë mundet për shembull të përbëhet prej rezistimit pasiv dhe të sulmit. Në anën tjetër, sulmi mund të mos rezultojë në ndonjë pengim pasi që qëllimi i fajtorit është vetëm të fyej personin zyrtar; për shembull hedhja e vezëve kundër automjetit i cili kishte persona zyrtar në të;

- Dëmi i Pasurisë së Luajtshme sipas nenit 260, paragrafi 1 i KPK, dhe për këtë shkelje, sipas nenit 260, paragrafi 1 i KPK.

14. Në secilin rast këto krime janë kryer në bashkëveprim ideal.
15. Trupi gjykues arriti në përfundim që të gjithë anëtarët e stafit të \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ të \_\_\_\_\_ në \_\_\_\_\_ (\_\_\_\_\_) bien brenda fushëveprimit të përkufizimit të personelit në

marrëdhënie me to në Kombet e Bashkuara. Përkufizimi "personeli në marrëdhënie me to" është i përkufizuar në nenin 142, pika (2) e KPK. Ai përfshin, në (i), "Personat e caktuar nga Qeveria apo një organizatë ndër qeveritare me marrëveshje me organin kompetent të Kombeve të Bashkuara". Rezoluta e KB 1244 "[e]inkurajon të gjithë Shtetet Anëtare dhe Organizatat Ndërkombëtare për të kontribuar në rindërtimin ekonomik dhe social (...)".<sup>17</sup> Ky përkufizim i "personelit të ndërlidhur me te" pason atë të deklaruar në Konventën mbi Sigurinë e Kombeve të Bashkuara dhe Personelit në Marrëdhënie me to.<sup>18</sup> Baza ligjore e Misionit pas Rezolutës së KB 1244 bazohen në marrëveshjen e KB. Në veçanti, Këshilli i Veprimit të Përbashkët të Bashkimit Evropian të datës 4 shkurt 2008 2008<sup>19</sup> deklaroi në preambulë:

"(1) Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1244 (tash e tutje Rezoluta 1244), dhe brenda kësaj kornize, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara:

– Vendos që prania ndërkombëtare civile dhe e sigurimit janë të vërtetuar për një periudhë fillestare prej 12 muajve, për të vazhduar më pas përderisa këshilli i sigurimit vendos ndryshe (paragrafi 19),

– 'Autorizon Sekretarin e Përgjithshëm, me ndihmë të organizatave relevante ndërkombëtare për të vërtetuar praninë civile ndërkombëtare në Kosovë (...)'"

---

<sup>17</sup> S/Res/1244 (1999) 10 qershor 1999, Paragrafi 13;

<sup>18</sup> I datës 9 dhjetor 1994, Neni 1 (b) (i);

<sup>19</sup> VEPRIMI I PERBASHKET I KESHILLIT 2008/124/CFSP te datës 4 shkurt 2008 te Misionit te Sundimit te Ligjit te Bashkimit Evropian, EULEX KOSOVO, dhe siç është ndryshuar nga VEPRIMI I PERBASHKET I KESHILLIT 2009/445/CFSP i datës 9 qershor 2009 duke ndryshuar Veprimin e Përbashkët 2008/124/CFSP mbi Misionin e Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian, EULEX Kosovo, Vendimi i Këshillit 2010/322/CFSP i datës 8 qershor 2010 duke ndryshuar dhe vazhduar Veprimin e Përbashkët 2008/124/CFSP mbi Misionin e Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian, EULEX Kosovo, VENDIMI I KESHILLIT 2012/291/CFSP i datës 5 qershor 2012, duke ndryshuar dhe vazhduar Veprimin e Përbashkët 2008/124/CFSP të Misionit të Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian, EULEX KOSOVO, VENDIMI I KESHILLIT 2014/349/CFSP i datës 12 qershor 2014 duke ndryshuar Veprimin e Përbashkët 2008/124/CFSP te Misionit të Sundimit të Ligjit të Bashkimit Evropian, EULEX Kosovo.

16. Prandaj, të gjithë anëtarët e stafit të \_\_\_\_\_ gëzojnë mbrojtjet e njëjta si personel të KB pasi që ata janë të konsideruar të jenë "personel me marrëdhënie me to".

17. Veprimet e atribuara të akuzuarve nuk janë përshtatur në përkufizimin e krimit të "Pjesëmarrjes në turmë që kryen vepra të rëndë" pasi që ata kanë qenë të akuzuar në aktakuzë. Krimi në vetë është përkufizuar si në vijim:

"Kushdo që merr pjesë në turmë të mbledhur që me veprim të përbashkët privon një person tjetër nga jeta e tij apo e saj, shkakton dëm të rëndë trupor personit tjetër, shkakton rrezik të përgjithshëm, dëm të pasurisë në shkallë të madhe, apo kryen vepra të tjera të dhunës së madhe, apo tenton të kryej vepra të tilla".

18. Veprimet të cilat janë përfunduar nga fajtorët nuk kanë eskaluar në masën e caktuar nga ky përkufizim. E as nuk ishte shkaktuar ndonjë lëndim i rëndë trupor e as rrezik i përgjithshëm. Rreziku i përgjithshëm i referohet rrezikimit të numrit të paspecifikuar të njerëzve. Gjithashtu nuk kishte pasur ndonjë shkallë të dëmit të madh të pasurisë. Trupi gjykues gjithashtu i ndërgjegjshëm që vlera e përgjithshme e automjetit dhe vlera e dëmit janë mjaft të vogla.

19. Vlerësimi i provave në lidhje me pikën kundër D. R., Z. J., B. D., U. B. dhe R. T. quan në përfundim që të akuzuarit nuk ishin fajtorë të krimit që ata ishin akuzuar.

20. E vetmja provë që ka treguar lidhjen e tyre me ngjarjet e datës \_\_\_\_\_ ishin fotografitë të bëra nga S. S. 1. në kohën kritike. Fotografitë ishin vërtetuar në mënyrë të duhur nga autori. Disa nga ata shpikën të sipërpërmendurit të akuzuarit si të pranishëm në vend të krimit.

21. Sidoqoftë, dëshmitari S. S. 1. tregoi në mënyrë precize momentin kur fotografitë ishin bërë: të gjitha nga ato ishin bërë kur situata në bllokimin e rrugës ishte e qetë. Duhet të thuhet që prania e vetme në rrugën ndërmjet automjeteve mund të kuptohet si bllokim i automjeteve nga rezistimi pasiv. Por në këtë rast nuk ka pasur prova në atë se sa gjatë të akuzuarit që ishin të pranishëm në fotografitë që kanë qëndruar në rrugë. Veprimi i personit i cili sapo iu ishte ofruar njerëzve dhe automjeteve që tashmë po qëndronin në rrugë dhe bisedonin me ata me qëllim kontribuan në pengimin e konvojit. Të gjitha dyshimet sa i përket momentit se kur të akuzuarit erdhën në vendin e krimit dhe kohëzgjatjen e pranisë së tyre atje duhej të merrej në favor të tyre.
22. Të pandehurit janë sjellë në mënyrën e përshkruar më lart edhe pse ata kanë qenë në gjendje të kuptojnë dhe kontrollojnë veprimet e tyre, të cilët ata kanë dëshiruar, duke e ditur që veprimet e tyre ishin të ndaluara dhe dënueshme me ligj.

#### **b. Përcaktimi i dënimit**

1. Gjatë përcaktimeve të dënimeve individuale për S. S. dhe B.J. për çdo krim bashkëveprues për të cilët ata janë shpallur fajtorë, trupi gjykues mori parasysh veprimet e tyre që nuk ishin të sofistikuar fare. Intensiteti i dhunës që ata kanë aplikuar ishte vlerësuar nga trupi gjykues si mesatar. Si faktor rëndësues trupi gjykues mori parasysh veprat e këqija dhe armiqësore kundër stafit të \_\_\_\_\_ në Veri të Kosovës në vitet e fundit. Fundi për siguri të përgjithshme së bashku me disa natyrë kolektive të veprimeve të tyre ishte marrë prandaj si faktorë rëndësues.

2. Në anën tjetër, trupi gjykues mori parasysht që ata të dy nuk janë dënuar deri më tani për ndonjë krim.
3. Gjobat janë përcaktuar në përpjesëtim me vlerën e dëmeve materiale që kanë shkaktuar të akuzuarit.
4. Kalkulimi i dënimeve të rënda ishte bërë duke marrë parasysht lidhjen e përkohshme shumë të afërt ndërmjet të gjitha krimeve të bashke ekzistuar.
5. Të dy të akuzuarit janë anëtarë të bashkësisë lokale. **B. J.** ka profesion të përhershëm dhe të rregullt me të ardhura mujore. **S.S.** ka një familje që përfshin dy fëmijë në moshën para shkollore.
6. Këto rrethana kanë qar trupin gjykues në vlerësim që të dy të akuzuarit kanë merituar ndërprerje të ekzekutimit të burgimit të caktuar kundër tyre. Trupi gjykues konkludoi që ka lidhje sociale dhe ekonomike që do të parandalonin ata nga kryerje e krimit në të ardhmen.
7. Ishte detyrë e trupit gjykues për të llogaritur kohën që **S.S.** ka kaluar në paraburgim në afat të burgimit që iu ishte caktuar atij.

## **VI. Shpenzimet**

1. Trupi gjykues bazuar në vendimin e tij mbi shpenzimet e procedurës penale mbi dispozitat ligjore citoi në dispozitiv. Niveli dhe proporcioni ndërmjet shumave të caktuara që **S. S.** dhe **B. J.** janë të obliguar të kompensojnë është përcaktuar duke pasur parasysht rëndimin e akuzave kundër atyre dhe numrit të veprimeve hetimore dhe

dëshmuese që janë marrë me qëllim të dëshmimit të këtyre akuzave. Gjithashtu ishte marrë parasysh që ka pasur të pandehur të tjerë në rast që janë liruar prej akuzave kundër atyre.

---

**Dariusz Sielicki**

Kryetari i Trupit Gjykes të EULEX-it

---

**Dukagjin Kerveshi**

Procesmbajtës

Mjeti juridik: i pandehuri, avokati i tyre mbrojtës, prokurori apo pala e dëmtuar i kanë 15 ditë afat për ankesë nga dorëzimi i këtij aktgjykimi në pajtim me nenet 380, paragrafi (1) dhe 381 paragrafi (1) i KPPRK. Çdo ankesë duhet të parashtrohet në gjykatë të shkallës së parë sipas nenit 388, paragrafi (1) i KPPRK.